



Comune di Firenze  
Assessorato al Terzo Settore Accoglienza Integrazione  
Direzione Sicurezza Sociale  
Consiglio Territoriale per l'Immigrazione - Firenze

# Immigrazione La normativa

Luigi Mughini / Anna Zucconi

(Guida ragionata al D.P.R. 18/10/2004, n. 334, concernente "Regolamento recante modifiche ed integrazioni al D.P.R. 31/8/99, n. 394, in materia di Immigrazione", ai sensi dell'art. 34, c.1, della L. 189/02)

# albanese

COMUNE network



Pubblicazione promossa dall'Assessorato al Terzo Settore, Accoglienza, Integrazione in collaborazione con il Consiglio Territoriale per l'Immigrazione - Firenze

**Testi:** Avv. Luigi Mughini, Associazione Progetto Arcobaleno Onlus

Anna Zucconi, Caritas Diocesana di Firenze

**Coordinamento:** Giuseppina Bonanni, Ufficio Immigrati, Direzione Sicurezza Sociale, Via Verdi 24, Firenze, tel. 055 2769791, e-mail [immigr@comune.fi.it](mailto:immigr@comune.fi.it)

**Responsabile Comune Network:** Maria Siponta De Salvia

**Coordinamento editoriale Comune Network:** Marta Cavini

**Traduzioni:** Cooperativa srl Mondo Unico

**Grafica e impaginazione:** Homographicus

**Stampa:** IT.COMM.

ISBN 88-89608-04-8

Le schede tematiche facilitate sono disponibili nelle seguenti lingue: albanese, arabo, cinese, inglese, rumeno, russo, somalo, spagnolo.

Tutti i testi sono alle pagine [www.comune.firenze.it/servizi\\_pubblici/stranieri/immigra.htm](http://www.comune.firenze.it/servizi_pubblici/stranieri/immigra.htm)

## **MARRJA E NENSHTETESISE ITALIANE**

(Acquisto della Cittadinanza Italiana) . . . . . pag. 6

## **QYTETARE JO KOMUNITARE**

(Assistenza Sanitaria) . . . . . pag. 15

## **CARTA DI SOGGIORNO**

(Carta di Soggiorno) . . . . . pag. 21

## **DISKRIMINIM PER ARSYE DISKRIMINIM PER RACIALE, ETNIKE, KOMBETARE E FETARE**

(Discriminazione per motivi razziali etnici, nazionali e religiosi) . . . . . pag. 24

## **REGJISTRIMI ANAGRAFIK (GJENDJE CIVILE) DHE DETYRIMET E MIKPRITESIT**

(Iscrizione anagrafica e obblighi dell'ospitante). . . . . pag. 27

## **PUNE AUTONOME (PER LLOGARI TE VET)**

(Lavoro Autonomo) . . . . . pag. 30

## **PUNE STINORE**

(Lavoro Stagionale) . . . . . pag. 34

## **PUNE SI DIPENDENT**

(Lavoro Subordinato) . . . . . pag. 37

## **MARTESA**

(Matrimonio) . . . . . pag. 42

## **MBROJTJA SOCIALE**

(Protezione Sociale) . . . . . pag. 44

## **BASHKIMI FAMILJAR**

(Ricongiungimento Familiare). . . . . pag. 46

## **VIZA E HYRJES DHE PERMESSO DI SOGGIORNO PER STUDIME**

(Visto d'ingresso e permesso di soggiorno per studio). . . . . pag. 50

## **ADRESA TE DOBISHME**

(Indirizzi Utili) . . . . . pag. 53

## Legenda

<b>ASL</b>	Azienda Sanitaria Locale
<b>CCIAA</b>	Camera di Commercio, Industria, Artigianato e Agricoltura
<b>CCNL</b>	Contratto Collettivo Nazionale di Lavoro
<b>CONI</b>	Comitato Olimpico Nazionale Italiano
<b>CPC</b>	Codice di Procedura Civile
<b>CPP</b>	Codice di Procedura Penale
<b>D.Lgs.</b>	Decreto Legislativo
<b>DM</b>	Decreto Ministeriale
<b>DPCM</b>	Decreto del Presidente del Consiglio dei Ministri
<b>DPL</b>	Direzione Provinciale del Lavoro
<b>DPR</b>	Decreto del Presidente della Repubblica
<b>MIUR</b>	Ministero dell'Istruzione dell'Università e della Ricerca
<b>U.T.G.</b>	Ufficio Territoriale del Governo
<b>Reg.</b>	Regolamento d'attuazione al Testo Unico
<b>Siast</b>	Servizio Integrato Assistenza Sociale Territoriale
<b>SSN</b>	Servizio Sanitario Nazionale
<b>STP</b>	Straniero temporaneamente presente
<b>SUI</b>	Sportello Unico per l'Immigrazione
<b>T.U.</b>	Testo Unico delle disposizioni concernenti la disciplina dell'immigrazione e norme sulla condizione dello straniero
<b>TAR</b>	Tribunale Amministrativo Regionale
<b>URP</b>	Ufficio Relazioni con il Pubblico

# MARRJA E NENSHTETESISE ITALIANE

## (ACQUISTO DELLA CITTADINANZA ITALIANA)

### 1) AUTOMATIKISHT

#### Eshte automatikisht qytetar italian:

- femija i nje babai ose nene italiane
- kush ka lindur ne territorin e Republikës<sup>1</sup>, nese te dy prinderit jane te panjohur ose apolid<sup>2</sup>, ose me mire nese femija nuk ndjek nenshtetesisine e prinderve sikurse parashikuar nga ligli i Shtetit te cilit i perkasin
- femija i prinderve te panjohur, i gjetur ne territorin e Republikës, nese nuk provohet zoterimi i nje neshtetesisie tjeter
- i huaji i adoptuar gjate moshes se mitur nga nje shtetas italian<sup>3</sup>

**Femijet e mitur te personave qe marrin ose rimarrin nenshtetesisine italiane**, nese jetojne me to, marrin nenshtetesisine italiane, por kur behen te rritur (mbi 18 vjec), mund t'a refuzojne nese jane ne zoterim te nje neshtetesisie tjeter.

### 2) DUKE BERE KERKESE

#### 2.a) I huaji ose apolidi (pa neshtetesi), babai ose nena apo njeri prej paraardhesve te grades 2° te se cilit ka qene shtetas italiane i lindur, behet shtetas:

- nese kryen sherbimin ushtarak<sup>4</sup> per Shtetin italian ose deklarone paraprakisht<sup>5</sup> qe deshiron te marre nenshtetesisine italiane;
- nese punon si nepunes<sup>6</sup> e Shtetit<sup>7</sup>, edhe jashte, e deklarone qe deshiron te marre nenshtetesisine italiane;

#### 2.b) I huaji i lindur ne Itali, qe ka qene rezident ligjerisht dhe pa nderprerje deri ne mberritjen e moshes se rritur (18 vjec), behet shtetas italian, nese deklarone qe deshiron te marre nenshtetesisine italiane brenda nje viti nga kjo date.

Ne rast se nuk eshte ne gjendje te demostroje mosnderprerjen e te qenit rezident ligjerisht pasi prinderit nuk kane bere rregullarizimin menjehere, ose e kane bere kete vetem mbas nje distance te madhe kohe nga momenti i lindjes se tij, i huaji lindur ne Itali mund te kerkoje marrjen e nenshtetesisine vetem nese ekzistojne kushtet e meposhtme<sup>8</sup>:

- lindja e tij, ndodhur ne Itali, eshte kallezuar rregullisht dhe menjehere ne gjendjen civile, edhe nga pikepamja e regjistrimit te populates
- nese prinderit, ne momentin e lindjes, ishin rregullisht rezidente me permesso di soggiorno te vlefshme dhe regjistrim anagrafik
- nese kjo shtate e ligjshme e prinderve ka vazhduar te qendroje per te gjithë periudhen e konsideruar, ose te pakten deri ne momentin kur femija ka marre nje permesso di soggiorno autonome.

Ndersa, nuk mund te beje kerkesa, i huaji i lindur ne Itali, qe ka nderprere rezidencen mbi territor perpara se te mbushe moshen e rritur (18 vjec).

#### Dokumentacioni i kerkuar:

- çertifikata e lindjes;
- çertifikata e nenshtetesisine italiane te lindur te babait ose te nenes ose te nje paraardhesit e grades se 2°;
- dokumentacion mbi rezidencen legale (per marrjen sipas kushteve pershkruar ne piken 2 b)

#### Organet e referimit:

Deklarata per zgjedhjen e nenshtetesisine (pika 1) dhe deklarata mbi vullnetin e shprehur per te kryer betimin (pika 2 a - b) i behen perpara Zyrtarit te Gjendjes Civile te Komunes ku deklaruesi eshte rezident ose mendon te stabilizojte rezidencen e vet, ose ne rastin kur eshte rezident jashte shtetit, perpara Autoriteteve diplomatike ose konsullare te vendit te rezidences.

#### 2.c) Natyralizimi<sup>9</sup>

##### Subjektet e interesuara:

##### Nenshtetesia mund t'i jepet:

- te huajt babai ose nena e te cilit, ose nje nga paraardhesit e grades se 2° ka qene italian i lindur, ose qe ka lindur ne territorin e Republikës e, ne te dyja rastet, eshte rezident prej te pakten 3 vjetesh;
- te huajt babai ose nena e te cilit, ose nje nga paraardhesit e grades se 2° ka qene italian i lindur. Ai mund te behet shtetas italian nese, ne momentin e mbushjes se moshes madhore, eshte rezident ligjerisht e pa nderprerje prej me shume se dy vjetesh, ne territorin italian e deklarone brenda nje viti nga permushja e kasaj moshe, qe do te marre nenshtetesisine italiane;
- te huajt te rritur, te adoptuar nga nje qytetar italian, qe eshte rezident ligjerisht ne territorin italian prej te pakten 5 vjetesh nga momenti i adoptimit;
- te huajt qe ka kryer sherbim, edhe jashte shtetit, per te pakten 5 vjet nen varesine e Shtetit italian;
- te huajt te nje Shteti perberes te Komunitetit Evropian, nese eshte rezident ligjerisht prej te pakten 4 vjetesh ne territorin italian;
- apolideve ose refugjateve politike rezidente ligjerisht prej te pakten 5 vjetesh ne territorin italian;
- te huajt qe eshte resident ne menyre te ligjshme prej te pakten 10 vjetesh ne territorin italian.

Kushtet e parashikuara per kerkesat e mesiperme per natyralizim, duhet te ekzistojne deri ne momentin e betimit perpara zyrtarit te Gjendjes Civile te Komunes se rezidences ose jashte perpara Autoriteteve diplomatike apo konsullare kompetente per lokalitetin e huaj te rezidences.

#### Organet e referimit dhe dokumentacioni i kerkuar:

##### Kerkesa, e adresuar Presidentit te Republikës italiane, me dokumentat e meposhtme bashkangjitur, i prezantohet Prefektures<sup>10</sup> ne 4 kopje:

- 1 kerkesa me pulle ligjore 14,62€ + 3 kerkesa ne leter te thjeshte
- 1 origjinale + 3 fotokopje te çdo dokumenti bashkangjitur

Kerkesa konsiston ne nje modular te prestampuar. Ky modular duhet te terhiqet prane Prefektures kompetente te vendit te rezidences se te interesuarit ose mund te shkarkohet nga sito web i prefektures<sup>11</sup>.

#### Dokumenta qe duhen bashkangjitur:

- çertifikata e lindjes me te gjitha gjeneralitetet, perkthyer ne italisht dhe legalizuar prane ambasades/konsullates italiane ose ne rast pamundesie te dokumentuar, atestatin e leshuar nga ambasada/konsullata e vendit te origjines ne te cilin duhet shenuar gjeneralitetet e sakta (emer, mbiemer, data dhe vendi i lindjes) si dhe atesia e memesia e kerkuesit;
- çertifikata historike e rezidences<sup>12</sup> ne bollo prej 14,62€ (e zevendesueshme nga autoçertifikimi);
- çertifikata e gjendjes familjare ne bollo prej 14,62€ (e zevendesueshme nga autoçertifikimi);
- çertifikate penale<sup>15</sup> nga vendi i origjines e nga vendet e tjera ku mund te kete qene rezident, te perkthyer ne italisht dhe te legalizuara nga organet kopetente te perfaqesise diplomatike ose consolare italiane (dokument i zevendesueshem nga autoçertifikimi vetem per qytetaret e Komunitetit Evropian)

- 5) certifikate e pergjithëshme e Casellario Giudiziale që kërkohe në Kancelerine e Prokurorisë së Republikës<sup>14</sup> (në bollo prej 14,62€ (e zëvendësueshme nga autoçertifikimi);
- 6) kopja e mod. 740 o 101 për trevjeçarin paraardhës datës së prezantimit të kërkesës ose certifikim i lëshuar nga Zyra kompetente e Taksave të Drejtëpërdrejta për persona të perket deklarimit të të ardhurave të prodhuar në trevjeçarin e fundit. Kopja e mod. 740 duhet autentikuar nga zyrtari i taksave të drejtëpërdrejta prane të cilit është prezantuar origjinali;
- 7) deklarata e refuzimit të mbrojtjes së autoriteteve diplomatike-konsullare italiane kundrejt Autoriteteve të vendit të origjinës, që plotësohet mbi modularin e prestampuar që merret në Prefekturë<sup>15</sup>;
- 8) deklarata e autorizimit të autoriteteve të vendit të origjinës që të furnizojë të gjitha informacionet mbi personin e vet që mund të kërkohe nga Autoritetet diplomatike italiane të vendosura prane shtetit të cilit i perket, që duhet plotësuar mbi modularin e prestampuar që merret në Prefekturë<sup>16</sup>.

#### Per të huajt refugjatë politike ose apolid (pa nënshtetësi):

- certifikata penale zëvendësohet me një akt notarial të bërë në Preturë, në të cilin të atësohet fakti që i huaji nuk ka kryer denime penale dhe që nuk ka çështje penale në gjykim në Vendin e origjinës;
- certifikata e lindjes zëvendësohet nga një akt notarial, formulari përparë Pretorit në vendin në të cilin është rezident, që përmban deklarinim e betuar të dëshmitarëve, në të cilin ata duhet të shenojnë emrin, mbiemrin, profesionin, rezidencën e të interesuarit dhe të prindërve nëse i kanë njohur, vendin dhe datën e lindjes, nënshtetësinë dhe shkakun për të cilin nuk mund të prodhohet certifikata e lindjes si dhe rrethanat rreth njohjes që secili dëshmitar ka mbi këto deklarime;
- certifikatën penale të vendit të origjinës e zëvendëson origjinalja ose kopja e autentikuar në Komunë e dokumentit me të cilin i shtë njohur gjendja si refugjat ose si i panënshtetësi.

#### 2.d) Martesa me qytetar/e italian/e<sup>17</sup>

##### Subjektet e interesuara:

I/e e huaji/a ose apolid, i martuar me një qytetar/e italian/e, nëse nëse nuk ka patur prishje martesë ose anulim ose mbarim të efekteve civile, mund të kërkojë nënshtetësinë italiane kur:

- a) ka rezidencën ligjore prej të paktën 6 muajsh në një komunë italiane ose
- b) mbas tre vjetësh nga data e martesës.

##### Shkaqë penguese

Egzistenca e çështjeve penale të rënda që sjellin probleme për siguresën e Shtetit.

**Leshimi i një dekreti refuzimi mund të pengohet** kur nga data e prezantimit të kërkesës, të plotësuar nga dokumentacioni i përshkruar, të ketë kaluar periudha e kohës prej 730 ditëve. Rehabilitimi nën të mundur pushimin e efekteve shtetërore të denimit, kurse kërkesa e refuzuar për shkaqë që kanë të bëjnë me sigurinë e Republikës, mund të perseritet mbas pesë vjetëve.

##### Organet e referimit dhe dokumentacioni i kërkuar:

**Kërkesa, e adresuar Presidentit të Republikës italiane, me dokumentat e mëposhtme bashkëgjatë, i prezantohet Prefekturës<sup>18</sup> në 4 kopje:**

- 1 kërkesë me pulle 14,62€ + 3 kërkesa në letër të thjeshtë
- 1 origjinale + 3 fotokopje të çdo dokumenti bashkëgjatë

Kërkesa konsiston në një modular të prestampuar. Ky modular duhet të terhiqet prane Prefekturës kompetente të vendit të rezidencës së të interesuarit ose mund të shkarkohet nga sito web i prefekturës<sup>19</sup>.

#### Dokumenta që duhen bashkëgjatë:

- 1) certifikata e nxjerrë nga regjistri i martesave, lëshuar nga Komuna italiane prane të cilit është shkruajtur ose rishkruajtur akti i martesës;
- 2) certifikata e lindjes e kompletuar nga gjeneralitetet apo, në rast pamundësie të dokumentuar, atestati i lëshuar nga Ambasada ose Konsullata në vendin e origjinës, përktër e legalizuar, me të cilin vërtetohen gjeneralitetet e sakta (emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes), si dhe atësinë e memësisë e kërkuar;
- 3) certifikata penale e Shtetit të vet të origjinës dhe e Shteteve të tjera në të cilat mund të ketë qenë rezident të përktër në gjuhën italiane (dokument i zëvendësueshem me një autoçertifikim vetëm për qytetaret e Komunitetit Evropian);
- 4) certifikatë historike e rezidencës (në bollo da 14,62€ e zëvendësueshme me autoçertifikim);
- 5) certifikatë nënshtetësie italiane të bashkëshortit (në bollo da 14,62€, e zëvendësueshme nga një deklarata zëvendësuese të aktit notarial<sup>20</sup>, me firmë të vene përparë nëpunësit që merr kërkesën;
- 6) certifikatë të pergjithëshme të casellario giudiziale që kërkohe prane Kancelerisë së Prokurorisë Firenze (në bollo da 14,62€ e zëvendësueshme me autoçertifikim);
- 7) certifikatë e gjendjes familjare (në bollo da 14,62€ e zëvendësueshme me autoçertifikim);
- 8) deklarata e lire në të cilin impenjohet të njoftojë menjëherë Prefekturën nëse do të ketë ndërrim të adresës ose rezidencës<sup>21</sup>.

#### Kohet dhe menyrat

Autoriteti që ka marrë kërkesën, në të gjitha rastet, menjëherë i trasmeton kërkesën Ministrisë së Brendëshme, dhe brenda 30 ditëve, nëse është e kompletuar dhe e rregullt, i dërgon të njëjtes Ministri dokumentacionin me vëzhgimet e veta dhe raportin informativ të Kuesturës<sup>22</sup>. Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni përkatës janë të pakompletuara ose të parregullta, brenda këtyre 30 ditëve autoriteti kompetent fton të interesuarin që t'ia komplotojë duke i dhënë shpjegimet dhe informacionet e duhura dhe kohet e proedures mbeten të pashkëputura deri në kryerje. Ministria pastaj kërkon opinionin e keshillit të Shtetit. Kur ky opinion është në favor, Ministria bën dekretin e dhenies i cili duhet të firmoset nga Presidenti i Republikës. Dekreti i trasmetohet Prefekturës e cila ia dërgon të interesuarit. **Koha për mbarimin e proedures është 730 ditë nga data e prezantimit të kërkesës. Dekreti i Ministrisë i trasmetohet menjëherë autoriteteve që kanë marrë kërkesën. Këto të fundit ia dërgon të interesuarit brenda 15 ditëve<sup>23</sup>. Qytetari i huaj të cilit është dhënë nënshtetësia, ka 6 muaj kohë nga notifikimi i dekretit për të bërë betimin prane Komunes në të cilin është rezident.**

I/e huaji/a ose apolid i martuar me një qytetar/e italian/e, që nuk ka marrë asnjë asnjë njoftim mbi dekretin e dhenies së nënshtetësisë ose refuzimit të kërkesës, mbasi kanë kaluar 730 ditët e parashikuara, maturon të drejtën për të marrë nënshtetësinë.

#### 3) NJOHJA E NËNSHTETËSISË ITALIANE QYTETAREVE TË HUAJ ME ORIGJINË ITALIANE<sup>24</sup>

**Mund të konsiderohet italian i prejardhuri nga shtetas italian<sup>25</sup>, edhe pse lindur jashtë dhe me rezidencë jashtë**

Kërkesat e njohjes së nënshtetësisë italiane duhet t'i adresohen Kryetarit të Komunes (Sindaco) italiane të rezidencës<sup>26</sup>, ose Konsullit italian kompetent për territorin në të cilin është rezident i huaji me origjinë italiane.

#### Këto duhet të plotësohen nga dokumentacioni si vijon:

- 1) certifikata e lindjes së italianit emigrant jashtë shtetit, lëshuar nga Komuna italiane e lindjes;
- 2) certifikata e lindjes e përktër zyrtarisht në italisht, e të gjithë personave prejardhës të drejtëpërdrejti, përftshire atë të personit që kërkon nënshtetësinë italiane;

- 3) akti i martesës i italianit emigrant jashtë shtetit, i perkthyer zyrtarisht në gjuhën italiane nëse është kryer jashtë shtetit;
- 4) aktin e martesës së të prejardhurve drejtpërdrejtë prej tij, përfshirë ato të prindërve të personit që kërkon nënshtetësinë italiane;
- 5) çertifikatë leshuar nga Autoritetet kompetente të Shtetit të huaj të emigracionit, të perkthyer zyrtarisht në gjuhën italiane, që vertetohet që italianin i emigruar jashtë shtetit në atë kohë, nuk mori nënshtetësinë e Shtetit të huaj para momentit të lindjes së prejardhës të të interesuarit;
- 6) çertifikatë të leshuar nga Konsullata italiane kompetente që vertetohet që as prejardhësit e drejtpërdrejtë dhe as personi që kërkon nënshtetësinë italiane, nuk kanë leshuar asnjehere ato çka përkrahur nga neni 7, ligji i 13 qershorit 1912, n. 555<sup>27</sup>;
- 7) çertifikatën e rezidencës.

Kërkesa prezantuar në Itali, duhet të shkruhet në leter ligjore dhe çertifikatat gjithashtu, nëse leshuar në Itali nga Autoritetet italiane, duhet të prodhohen conforme dispozitivave ligjore; çertifikatat e leshuara nga Autoritetet e huaja duhet të shkruhen në leter të thjeshtë dhe të legalizohen, përveç rasteve kur parashikohet përjashtimi nga legalizimi në bazë të konvencioneve ndërkombëtare të bërë nga Italia. Dokumentet e mesipërme duhet të perkthehen zyrtarisht në gjuhën italiane, dhe nëse këto do të prezantohen në Itali, perkthimet duhet të shkruhen në leter me pulle ligjore (carta da bollo).

Kryetari i Komunes, pasi verifikon vertetësinë e pretendimit të bërë nga kërkuësit e nënshtetësisë në bazë të "iure sanguinis", disponon nënshtetësinë e akteve të gjendjes civile e procedon për leshimin e çertifikatës së posaçme të nënshtetësisë.

**Personat me prejardhje nga territori italian që bente pjesë në perandorinë austro - hungareze të atehershme,** që emigruan jashtë shtetit përpara 16 korrikut 1920, dhe prejardhësit e tyre, mund të marrin nënshtetësinë italiane atëherë kur bëjnë, brenda 20 dhjetorit 2005, një deklaratë Zyrtarë civile të shtetit në komunën ku janë rezidentë ose ku duan të behen rezidentë, ose përpara Autoriteteve diplomatike ose konsullare të vendit të rezidencës, nëse rezident jashtë shtetit<sup>28</sup>.

#### VINI RE:

**Gjeneralitetet e shkruajtura në dokumentat italiane dhe të huaj duhet të jenë gjithmone të sakta dhe të njëjta në të gjitha aktet** e, duke qenë se në ekzaminimin e rregullsisë së dokumentacionit të prezantuar do t'i behet referim gjithnjë gjeneraliteteve të prodhuara në dokumentacionin e huaj (çertifikata origjinale e lindjes, passaporta, çertifikata penale e vendit të origjinës dhe/ose të një vendi rezident tjetër nëse ka), këto duhet të jenë në aktet e leshuara nga autoritetet italiane (rezidenca, martesë, permesso di soggiorno, gjendja familjare, çertifikata e çështjeve për gjykim dhe "casellario giudiziale"), edhe pse emrat e parashikuara nga normativat shtetërore të origjinës janë të ndryshëm nga ato të normave italiane<sup>29</sup>.

Mospërputhjet që mund të vertetohen të shkruajtura në dokumentacion mund të sistemohen nepermjet një atestimi me të cilin Konsullata e Shtetit nga i cili vjen të deklarojë që gjeneralitetet e ndryshme në këte rast i referohen të njëjtit person, duke spjeguar cilat janë ato të sakta e duke sqaruar arsytet për të cilat këto janë ndryshe në dokumenta<sup>30</sup>. Nëse ka mospërputhje mbi vendin e lindjes, vertetimi i konsullatës duhet të japë edhe këto spjegime

#### Perkthimi dhe legalizimi i dokumentave:

Dokumentat e përkrahura në pikat 1 dhe 4 duhet të **perkthehen** në gjuhën italiane në Ambasaden ose Konsullatën italiane të Shtetit në të cilin është leshuar dokumenti, ose nga një perkthyes zyrtar, apo nga

Konsullata ose Ambasada e vendit të vet në Itali të **legalizuara** pranë Ambasadës ose Konsullatës Italiane prezente në Shtetin ku është leshuar dokumenti.

Nëse janë leshuar në një nga Shtetet e mëposhtme, këto dokumenta mund të **legalizohen nepermjet një vule me shenim**, të venë nga autoritetet kompetente në Shtetin ku është leshuar dokumenti<sup>31</sup>:

Andorra, Antigua e Barbuda, Argjentina, Armenia, Australia, Azerbaixhan, Bahamas, Barbados, Belize, Bielorusia, Bosnia-Erzegovina, Botswana, Brunei, Bullgaria, Cipro, Colombia, Domenica, El Salvador, Estonia, Federacioni Russ, Fij, Japonia, Grenada, Honduras, Hong Kong, Ishujt Marshall, Izraeli, Kazakistan, Lesotho, Letonia, Liberia, Lituania, Makao, Malawi, Malta, Mauritius, Meksika, Monako, Namibia, Niue, Norvegjia, Zelanda e Re, Holanda, Panama, Republika Çeke, Rumania, Saint Kitts e Nevis, Saint Vincent e Grenadine, Samoa, Santa Lucia, Seychelles, Serbia e Mali i Zi, Suriname, Svicra, Swaziland, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Afrika e Jugut, Tonga, Trinidad e Tobago, Ukrahina e Venezuela.

#### **Të njëjtat dokumenta nuk kanë nevojë për legalizim nga ana e Autoriteteve diplomatike italiane dhe as për shenim nga ana e Zyres kompetente nëse janë leshuar në një nga Shtetet e mëposhtme:**

Austri, Belgjike, Kroaci, Danimarkë, Finlande, Francë, Gjermani, Britaninë e Madhe, Greqi, Irlandë, Liechtenstein, Luksemburg, Maqedoni, Norvegji, Vendet e Uletë, Portugali, San Marino, Sllovaki, Spanjë, Suedi, Svicra, Turqi e Hungari.

**Qytetaret e huaj lindur në Kosovë:** aktet administrative të leshuara nga UNMIK, në përgjithësi nuk kanë nevojë, të legalizohen në Zyrën Konsullare italiane në Prishtinë, kështu që kur është e nevojshme, mund të procedohet me këte legalizim në formën e atestimit të vendit prejardhës dhe vertetësisë së firmës së venë në këte aktë nga leshuesi i tyre<sup>32</sup>.

Për **leshimin e dokumentave qytetareve irakene**, është kompetent "Seksioni për mbrojtjen e interesave të republikës së Irakut" pranë Ambasadës italiane në Sudan<sup>33</sup>.

## 4) HUMBJA E NENSHTETËSISË ITALIANE

### 4.a) Per braktisje

Qytetari që zoteron, merr, ose rimerr një nënshtetësi të huaj ruan atë italiane, përveç rasteve kur rregullorja e huaj parashikon humbjen automatikisht të nënshtetësisë në rast marrjeje ose rimarrjeje vullnetarisht të nënshtetësisë tjetër. Ai mund të braktisë nënshtetësinë italiane, në rast se është rezident ose stabilizon rezidencën e tij jashtë<sup>34</sup>.

Për të braktisur nënshtetësinë italiane duhet të egzistojnë këto kushte:

- mbajtja e një nënshtetësie tjetër
- mbajtja ose transferimi i rezidencës jashtë shtetit

Humbja ndodh në ditën e pasme mbas asaj në të cilën personi ka dhënë deklaratën e braktisjes.

### 4.b) Per Konvencionin e Strasburgut<sup>35</sup>

Konvencioni thotë që qytetaret rezidentë jashtë, të Shteteve nënshtetëse (Austria, Belgjika, Danimarkë, Luksemburgu, Norvegjia, Suedia, Britaninë e Madhe, Irlanda e Spanja, Franca e Vendet e Uletë) humbin nënshtetësinë në rastin kur marrin ose rimarrin vullnetarisht nënshtetësinë e një Shteti tjetër që ka nënshtetësinë Konvencionin: ato nuk mund të autorizohen që të mbajnë nënshtetësinë paraardhëse.

Si pasojë, shtetasi italian rezident jashtë që merr vullnetarisht nënshtetësinë e një nga Shtetet që nënshtetësohen (me përjashtim të Britanisë së Madhe, Irlandës e Spanjës, që kanë nënshtetësinë vetem kapitullin e Konvencionit që ka të bëjë me detyrimet ushtarake në rast nënshtetësie të shumefishtë, e të Gjermanisë, që nuk ka nënshtetësinë Konvencionin), humb nënshtetësinë italiane.

Konvencionin e Strasburgut disiplinon edhe normat mbi nënshtetësinë e të miturve, në varesi të atyre të nënshtetësisë së prindërve<sup>36</sup>.

Italia gjithashtu ka njohur edhe Protokollin e Dytë të emendimitit në Konvencionin e Strasburgut të vitit

1963, nenshkruar ne gjendjen aktuale, edhe nga Franca e nga Vendet e Uleta. Ne baze te ketij Akordi, kur nje qytetar i nje Vendi nenshkruet merr nenshtetesine e nje tjeter Vendi nenshkruet ne territorin e te cilit ka lindur dhe eshte rezident, ose nese ka qene rezident ne menyre te vazhdueshme duke filluar nga nje date paraardhese dites se mbushjes se vitit te 18° te moshes, gjithesecila prej ketyre Vendeve mund te disponoje mbajtjen e nenshteteses origjinale. Ne rast martese midis shtetasve te dy vendeve te ndryshme nenshkruese, gjithesecila pale mund te disponoje qe qytetare qe merr me vullnetin e tij nenshtetesine e bashkeshortit, te ruaje nenshtetesine e vet te origjines.

#### 4.c) Per braktisje nga ana e kujt ka fituar/rifituar nenshtetesine gjate moshes se mitur<sup>37</sup>

Ata qe kane marre nenshtetesine italiane gjate moshes se mitur, sepse femije bashkejetues me prindin qe ka fituar/rifituar nenshtetesine, kane mundesine qe t'a braktisin ate (pa kufi kohe), kur behen te rritur, gjithmone nese zoterojne nje nenshtetesi tjeter.

#### 4.d) Per braktisje ose sanksion nga ana e te adoptuarit ne rast anulimi te adoptimit

Mund te braktise nenshtetesine italiane subjekti i rritur ne zoterim te nje nenshtetesi tjeter (edhe pse rezident ne Itali), ne rast **anulimi te adoptimit per shkaqe qe i perkasin adoptuesit**. Braktisja duhet te behet brenda nje viti nga anulimi<sup>38</sup>.

Anullimi i adoptimit per **faj te te adoptuarit**, ka si pasoje humbjen automatikisht te nenshteteses se fituar nga ky i fundit per efekt adoptimi, vetem nese ai ka nje tjeter nenshtetesi ose nese e merr ate<sup>39</sup>.

Shtetasit qe braktisin nenshtetesine italiane sic pershkruar ne pikat c) e d), mund t'a marrin perseri vetem mbas natyralizimit pershkruar ne piken 2, paragrafet c) dhe d).

#### 4.e) Humbja per sanksion<sup>40</sup>

Parashikohet humbja e nenshteteses italiane edhe ne rastin kur

- nuk i bindet urdherit te Qeverise italiane qe te lere nje nepunesi publike ose nje post public qe shtetasi ka pranuar nga nje Shtet ose ent public i huaj nderkombetar ne te cilin nuk merr pjese l'Italia; nuk i bindet fteses qe te braktise sherbimin ushtarak qe shtetasi kryen per nje Shtet te huaj;
- marra e nje posti pulik ose e nje sherbimi ushtarak per nje Shtet te huaj, ose marrjen vullnetarisht te nje nenshtetesi te ketij Shteti, kur ne rrethana te vecanta te egzistojte gjendja e luftes me te.

Ne hipotezat e mesiperme, duke qene se behet fjale per sanksione, humbja e nenshteteses nuk kondicionohet nga zoterimi i nje nenshtetesi tjeter dhe, ne rastine dyte nuk lejohet rimarrja e nenshteteses.

## 5) RIFITIMI I NENSHTETESISE ITALIANE

### Mund te rifitoje nenshtetesine italiane<sup>41</sup>:

- kush kryen sherbimin ushtarak per Shtetin italian dhe deklaron paraprakisht qe do te marre nenshtetesine italiane;
- kush, duke marre ose i marre ne pune ne nje post publik nen varesine e Shtetit, edhe jashte, deklaron qe do te rifitoje nenshtetesine italiane;
- kush deklaron qe do te rifitoje nenshtetesine italiane dhe ka marre ose do te marre brenda nje viti nga deklarata, rezidencen ne Itali;
- i huaji (qe ka qene shtetas italian) i cili pas nje viti nga data qe ka marre rezidencen ne Itali, nuk ka braktisur shprehimisht ne te njejten periudhe me rifitim e nenshteteses italiane. Vetem ne kete rast rifitimi behet automatikisht: megjithate ligji parashikon mundesine e braktisjes nga ana e te interesuarit per te garantuar mbrojtjen e vullnetit;
- kush, duke pas humbur nenshtetesine italiane pasi nuk i eshte bindur urdherit qe te braktise nepunesimin ose postin e pranuar nga nje Shtet, nga nje ent publik i huaj ose nga nje ent nderkombetar, apo sherbimin ushtarak per nje Shtet te huaj, deklaron qe do t'a rifitoje, me kusht qe

te kete stabilizuar rezidencen prej te pakten dy vjetesh ne territorin e Republikes dhe qe provon se ka braktisur nepunesimin ose postin ose sherbimin ushtarak, te mbajtura ose te kryera pavaresisht nga urdheri.

<sup>1</sup> Jane "territori i Republikes" edhe anijet e shenuara ne regjistrat detare italiane e aeroplanet e shenuar ne Regjistrin Aeronautik Nacional, me flamur italian. Kjo ne rastet kur jane ne baze te se drejtes nderkombetare, subjekte nen urdherin italian qe nuk i nenshtrohet nje ligji territorial te huaj. Per anijet, kjo rrethane verifikohet kur ndodhen ne lundrim jashte ujerave territoriale.

<sup>2</sup> Ministria Bendeshme mund te certifikojte gjendjen prej apolidi (pa nenshtetesi), mbi bazen e kerkeses se te interesuarit, plotesuar nga akti i lindjes, dokumentacioni mbi rezidencen ne Itali, e te cdo dokumenti tjeter te vlefshem qe demonstron gjendjen prej apolidi (D.P.R. 572/93, neni 17)

<sup>3</sup> I mituri behet shtetas italian me nenshkrimin e urdheres se adoptimit, por me fillim mbas dates se prononcimit te tij (neni 34 pika 3, ligji n°476 i vitit 1998). Qe te behet marrja e nenshteteses italiane, eshte e nevojshme qe te pakten njeri prej prinderve adoptiv te jete shtetas italian ne momentin ne te cilin merr vlefshmeri vendimi gjyqesor italian apo i huaj, per adoptimin. Ndersa, ne qofte se prinderit adoptiv ne ate moment jane te huaj dhe jane duke marre nenshtetesine italiane mbas adoptimit, ndryshimi i nenshteteses se te miturit behet me nje komunikim per te drejten e tij.

<sup>4</sup> "Konsiderohet qe ka bere efektivist sherbimin ushtarak kush ka bere sherbimin ne Forzat e Armatosura Italiane ose sherbim te barazueshem me ate ushtarak, me kusht qe keto te jene kryer ne teresine e tyre, pervec rastit kur mungesa e kesaj te jete bere per shkak te forcave madhore te njohura nga Autoritetet kompetente" – D.P.R. 572/93, Rregullorja e ekzekutimit te ligjit, sic pershkruar ne piken 1, neni 1, comma 1 b).

<sup>5</sup> Me qellim qe te verifikohen efektet e ligjit, duhet qe i interesuari te deklaroje paraprakisht qe do te permbushe sherbimin ushtarak per te marre nenshtetesine italiane.

<sup>6</sup> Deklarimi nuk mund te behet mbasi ka mbaruar nepunesimi publik

<sup>7</sup> "Pervec rasteve ne te cilat ligji kerkon ne menyre specifike egzistencen e nje raporti si nepunes publik, konsiderohet qe ka kryer sherbim nen varesine e Shtetit kush ka qene pjese e nje raporti pune si vartess me pagese ne ngarkim te bilancit te Shtetit" – D.P.R. 572/93, neni 1, pika 1 c).

<sup>8</sup> Opinioni i Keshillit te Shtetit, Seksioni I, i datess 16.11.1996

<sup>9</sup> Nuk kerkohet me certifikata e heqjes se nenshtetesise originale te qytetareve te huaj qe duan te marrin nenshtetesine italiane (D.M. 7.10.2004)

<sup>10</sup> Ne rastet e pershkuara ne piken d), kerkesa i prezantohet Autoriteteve Konsullare italiane ne Vendin e rezidences se te huajit (D.P.R. 362/94 neni 1 pika 1).

<sup>11</sup> <http://www.prefettura.firenze.it/indiceserv.htm>

<sup>12</sup> Trejçetare, katenvjçetare, pesenvjçetare, shtatenvjçetare, dhjetenvjçetare, sipas rasti: **ne rast se Komunitet e rezidences ligjore kane qene me shume se nje, duhet prezantuar nje certifikate anagrafike historike per çdo Komune.**

<sup>13</sup> Ne rast se rregulloja e shtetit te origjines nuk parashikon leshimin e nje certifikate te tille, duhet prodhuar nje akt notarial. Ne nje akt te tille deklaruesi duhet te deklarroje qe nuk ka marre decime penale dhe qe nuk ekzistojne çeshtje penal ne ngarkim e tij ne vendin e vet te origjines; ne kete rast, dklaruesi duhet gjithashtu te prodhoje nje atestat te leshuar nga Konsullata kopetente ne te cilen te deklarohet qe nuk ekziston ne shtetin e origjines lesimi i nje certifikate penale.

<sup>14</sup> Prokuroria e Republikës Firenze, Viale S.Lavagnini 31, tel. 055 2404629

<sup>15</sup> Modulari mund te shkarkohet nga sito web i Prefektures Firenze (shiko piken 11).

<sup>16</sup> Shiko piken 15.

<sup>17</sup> Presupozohet per marrjen e nenshtetesise ne nje moment historik te caktuar kur verifikohen rrethanat dhe kushtet juridike te pershkuara ne pikat a) ose b) (cfr. Keshilli i Shtetit, opinione n. 2487\1992 te dates 30.11.1992 e n. 347\1993 te dates 17.5.1993). Per kete modifikimet e ndodhura tej ketij momenti historik (zgjidhja e martesës per shkak divorci nga bashkeshorti italian ose per shkak vdekjeje te ketij te fundit; transferimi i rezidences jashte shtetit, - ne rastin kur per marrjen e nenshtetesise italiane te vlej kerkesa e rezidences ne Itali prej 6 muajsh mbas martesës etj.) jane te pavlefshme mbas prezantimit te kerkeses.

<sup>18</sup> Ne rastet e pershkuara ne piken b), kerkesa mund te prezantohet nga Autoritetet konsullare italiane ne Shtetin e rezidences (D.P.R. 362/94 neni 1 pika 1).

<sup>19</sup> Shiko piken 11.

<sup>20</sup> Modulari gjendet prane Prefektures Firenze ose shkarkohet nga <http://www.prefettura.firenze.it/indiceserv.htm>

<sup>21</sup> Shiko piken 20.

<sup>22</sup> Me qellim qe te verifikohet mire egzistenca e elementeve te tille qe bejne legjitime ndryshimin e nenshtetesise origjinale apo, sidoqofte, ne momentin e marrjes se nenshtetesise italiane, Kuestura duhet te furnizojë edhe elementet e meposhtem te cilat kane peshe ne menyre te veçante (te tilla lajme mund te nxirren edhe nga bashkëbesedimet ne ate moment): niveli i asimilimit te kultures dhe integronit ne ambientin italian nga ana e subjektit ne fjale; niveli i njohjes se gjuhës italiane e i parimeve themelore nga e cilat udhehiqet jeta italiane; perberja e familjes se kerkuesit dhe niveli i integritimit ne shoqerine italiane sidomos ajo e bashkeshortit, e aktivitetit te punes qe zhvillojne perberesit mbi moshen 18 vjeç dhe e pagesës se rregullt te taksave ne pergjithesi; lajmet mbi femijet e mitur qe bejne pjese ne berthamen familjare, duke pare permbushjen e detyrimeve shkollore te parashikuara nga ligji; specifikimin e bere nga çdo perberes i familjes ne ate moment mbi kerkesen e nenshtetesise italiane (Ministria e Brendeshme – Circolare n. K.60.1/86 e dates 7.11.1996)

<sup>23</sup> D.P.R. 362/94 neni 4 e 5.

<sup>24</sup> Ministria e brendeshme – Circolare n. K.28.e dates 8.4.1991

<sup>25</sup> Qytetareve italiane te martuara mbas 1 janarit 1948 dhe shtetasit italianë bashkeshorti i te cilave ka humour nenshtetesine italiane mbas 1 janarit 1948, me vullnet te lire, u njihet mbajtja e panderprere e nenshtetesise italiane. Kjo njohje mund te behet edhe per prejardhesit e drejtperdrejte. Femijet e grave qe, edhe pse te martuara mbas dates 1 janar 1948, nuk kane mundur te shprehin vullnetin e lire te pershkuar me siper, nese e kerkojne, mund te konsiderohen shtetas italianë (Ministria e brendeshme – Circolare n. K.60.1 e dates 8.01.2001).

<sup>26</sup> Prejardhesit nga shtetas italianë, me permesso di soggiorno te rregullt, regjistronen ne gjendje civile pavaresisht nga afati i skadences (Circolare e Ministrise se Brendeshme n. 28 e dates 23.12.2002)

<sup>27</sup> "Salvo speciali disposizioni da stipulare con trattati internazionali, il cittadino italiano nato e residente in uno stato estero, dal quale sia ritenuto proprio cittadino per nascita, conserva la cittadinanza italiana, ma divenuto maggiorenne o emancipato, può rinunziarvi".

<sup>28</sup> Ligji 379/2000, neni 1 – "Dispozita per njohjen e nenshtetesise italiane personave lindur dhe rezidente ne territoret qe i perkisnin perandorise austro-hungareze dhe prejardhesve te tyre", Ministria e Brendeshme – Circolare n. K.78 e dates 19.02.2001

<sup>29</sup> Konvencioni i Monakas i dates 5.9.1980 – Ligji 31.05.1995, n. 218, neni 24, pika 1

<sup>30</sup> I interesuari do te ftohet te plotesojë dokumentacionin italian conforme gjeneraliteteve qe rezultojne ne dokumentacionin e huaj, brenda nje peridudhe te arsyeshme kohe (te pakten 4 muaj) – Ministria e Brendeshme – Circolare n. K.60.1/86 e dates 7.11.1996.

<sup>31</sup> Konvencioni Aja, 5.10.1961 mbi heqjen e detyrimit te legalizimit te dokumentave te huaja publike

<sup>32</sup> Ministria e Brendeshme – Circolare n. 51/2004 "Qytetaret e huaj lindur ne Kosove: vlefshmeia e dokumentave dhe certifikatave te leshuara nga UNMIK"

<sup>33</sup> Shenimi n. 303/346415 i dates 29.07.2004, ne baze te Emendamentit n. 16, perhapur me 1.12.2003 nga Autoritetet Provisore te Koalicionit

<sup>34</sup> Ligji 91/1992, neni 11

<sup>35</sup> Konvencioni i Strasburgut i dates 6.05.1963 mbi reduktimin e rasteve te nenshtetesive te shumefishta e detyrimet ushtarake ne rast nenshtetesie te shumefishte, i njohur me Ligjin 4.10.1966, n. 876, e Protokollin e Dyte te emendamentit e Konvencionin e Strasburgut te dates 14.12.1994, n. 703 (njohur nga Italia e Franca me 24.3.1995 dhe nga Italia e Vendet e Uleta me 20.8.1996).

<sup>36</sup> Neni 1, pika 3; neni 2

<sup>37</sup> Ligji 91/1992, neni 14

<sup>38</sup> Ligji 91/1992, neni 3, pika 4

<sup>39</sup> Ligji 91/1992, neni 3, pika 3

<sup>40</sup> Ligji 91/1992, neni 12

<sup>41</sup> Ligji 91/1992, neni 13

## QYTETARE JO KOMUNITARE (ASSISTENZA SANITARIA)

**Regjistrimi ne Servizio Sanitario Nazionale SSN (Sherbimin Shendetesor Nacional) garanton asistencë te plote sanitare me kushte te barabarta me shtetasit italianë, persa i perket detyrimit kontributiv, asistences se dhene ne Itali nga vete SSN dhe vleres se saj ne kohe. Kushteve te mesiperme i shtohen edhe asistencë per rehabilitim dhe proteza.**

### 1) REGJISTRIMI I DETYRUESHEM NE SHERBIMIN SHENDETESOR KOMBETAR

#### Subjektet e interesuara:

Te huaj me permesso di soggiorno ose qe kane kerkuar rinovimin e permesso di soggiorno per nje nga arsytet e meposhtme:

- pune si dependent
- pune si i pavarur
- arsye familjare
- azil politik
- motive humanitare
- kerkese per azil<sup>1</sup>
- ne pritje te nje adoptimi
- marrje nen kujdestari
- per marrjen e nenshtetesise
- arsye fetare<sup>2</sup>

Asistencë sanitare i takon edhe **familjareve ne ngarkim**, me leje te rregullt qendrimi (nese nuk kane permesso di soggiorno qe u jep te drejten e asistences ne emrin e vet) dhe, qe nga lindja, edhe femijeve te mitur nen 18 vjeç.

Per punetorin e huaj stinor, regjistrimi behet per te gjithë periudhen e aktivitetit te punes, prane Qendres Sanitare Lokale (ASL) te komunes per te cilen eshte leshuar leja e qendrimit (permesso di soggiorno)

Regjistrimi ne SSN **nuk eshte i detyrueshem per kategorite e punetoreve te huaj qe vijojne<sup>3</sup>**, te cilet nuk duhet te paguajne ne Itali per aktivitet zhvilluar ne te, taksa mbi te ardhurat e personave fizike:

- drejtues ose personel teper te specializuar te shoqerive qe kane qender ose filiale ne Itali
- drejtues ose personel teper te specializuar te zyrave perfaqesues te shoqerive te huaja qe kane qendren kryesore te aktivitetit ne territorin e nje Shteti qe ben pjese ne Organizaten boterore te tregtise
- drejtues te qendrave kryesore ne Itali te shoqerive italiane ose te shoqerive te nje tjetër Shtet pjeseberes ne Bashkimin europian
- punetore dependent rregullisht te paguar nga punedhenesi, persona fizike e juridike, me rezidence jashte Italise drejtpersedrejti nga ata paguar, te cilet jane transferuar perkohesisht nga jashte prane personave fizike o juridike italiane ose te huaj rezidente ne Itali, me qellim qe te kryejne ne territorin Italian veprime te percaktuara nga nje kontrate-tender lidhur midis personave te mesiperme fizike o juridike rezidente ose me qender ne Itali dhe atyre rezidente ose me qender jashte
- gazetave ose korrespondente zyrtarisht te njohur ne Itali dhe dependente rregullisht te paguar nga organet e gazetave ose revistave, ose nga trasmetues radiofonike ose televizive te huaj
- te huaj titullare te leje qendrimi (permesso di soggiorno) per tregti

- 16 Per keta qytetare te huaj mbetet detyrimi qe te sigurohen kunder semundjeve, peripevice dhe shtatezanise nepermjet siguracioneve me nje institut sigurativ italian ose te huaj, te vlefshme mbi territorin nacional, ose nepermjet regjistrimit vullnetar ne SSN e vlefshme edhe per familjaret ne ngarkim. Per regjistrimin ne SSN duhet te paguhet nje kontribut prej € 387,34

Qytetaret e huaj me permesso di soggiorno te leshuar per **motive turistike ose per kurim**, nuk kane te drejte te regjistroheshen ne SSN dhe duhet te paguajne koston e plote te trajtimeve sanitare te marra.

### Vendi dhe kushtet per regjistrimin

Prane qendres territoriale (Distretto Socio Sanitario) te ASL te Komunes se rezidences ose te Komunes ku efektivisht banon (ate qe rezulton mbi permesso di soggiorno<sup>4</sup>).

## NUK ESHTË E NEVOJSHME REZIDENZA ANAGRAFIKE NE ITALI

### Per te bere kerkesen e regjistrimit jane te nevojshme:

- permesso di soggiorno (ne rast rinovimi, fleta e kerkeses per rinovim)
- nese i papune: çertifikata e regjistrimit ne listat e punes

### Kohezgjatja e regjistrimit

Regjistrimi nuk bie ne faze rinovimi te permesso di soggiorno.

Regjistrimi bie ne rast mosrinovimi, revokimi ose anulimi te permesso di soggiorno ose per ekspulsion, te komunikuar ASL-it nga questura, pervec rastit kur i interesuari demonstron dokumentacionin qe provon se ai ka bere kerkesen kunder vendimeve te siperpermdura.

Pasi behet regjistrimi merret **Dokumenti per Asistencen Sanitare** e cila jep te drejten te marresh falas ose me pagesen e Ticket<sup>5</sup>, sherbimet e meposhtme:

- vizita mjekesore te pergjitheshme ne ambulance dhe vizita mjekesore tek specialisti
- vizita mjekesore ne shtepi
- shtrime ne spital
- vaksinime
- analiza gjaku, radiografi, ecografi etj.
- ilace
- asistencen per rehabilitim e proteza etj.

Ne rast vjedhjeje ose humbjeje, duke shkuar me nje dokument identiteti ne qendren sanitare ku eshte bere kerkesa e duke plotesuar autoçertifikimin e denoncimit, behet leshimi i nje duplete.

## 2) REGJISTRIMI VULLNETAR NE SHERBIMIN SANITAR NACIONAL

### Subjektet e interesuara

Te huaj me permesso di soggiorno te vlefshme per me shume se tre muaj per arsye te ndryshme nga ato te permdura me siper. Keta te huaj duhet te sigurohen kunder semundjeve, peripevice e shtatezanise ne nje nga menytrat e meposhtme:

- nepermjet nje **siguracioni** te vlefshem ne territorin nacional me nje institut sigurimi italian apo te huaj (kontrolloni c'loj sigurimi eshte i parashikuar nga siguruesi)
- nepermjet **regjistrimit ne SSN me nje pagese vjetore prej € 387,34**. Regjistrimi eshte i vlefshem edhe per familjaret ne ngarkim pervec:

- te huaj me permesso per studime: studentet mund te sigurohen (si me siper) ose te regjistroheshen vullnetarisht ne SSN duke derdhur shumen prej €149,77 euro (nese me familiare ne ngarkim, shuma eshte €387,34);
- te huajt e vendosur **alla pari** qe mund te bejne nje kontrate sigurimi (si me siper) ose te shkruhen vullnetarisht ne S.N.N duke derdhur shumen e parashikuar prej €219,49 euro.

### Vendi dhe kerkesat per regjistrimin:

Prane qendres territoriale (Distretto Socio Sanitario) te ASL te Komunes se rezidences ose te Komunes qe rezulton mbi permesso di soggiorno<sup>6</sup>.

## NUK ESHTË E NEVOJSHME REZIDENZA ANAGRAFIKE NE ITALI

### Per kerkesen e regjistrimit jane te nevojshme:

- kopje e siguracionit ose mandati i pageses ne SSN te shumes se parashikuar
- nje permesso di soggiorno me vlefshmeri mbi tre muaj (edhe me pak per studentet, kerkuesit e azilit ose me sistemim alla pari).

### Periudha e regjistrimit

Regjistrimi vullnetar **skadon ne 31 dhjetor** duhet te rinovohet çdo vit. Shuma duhet te derdhet e plote edhe nese regjistrimi behet gjate vitit.

Te huajve qe zoterojne nje **PERMESSO DI SOGGIORNO TE VLEFISHME ME PAK SE TRE MUAJ**, pra jo te regjistruar ne SSN, ju sigurohen sherbimet shendetesore te ofruara nga SSN me pagese te plote. Tarifat e sherbimeve sanitare percaktohen nga Rrethet dhe Provincat e Pavarura.

Perjashtohen nga pagesa e te tilla tarifave te huajt e pajisur me atestat te drejte asistencen sanitare, pasi prejardhur nga vende me te cilat Italia ka neshkruar **traktate e akorde bilaterale** : *Australi, Argjentine, Bosnje-Herzegovine, Brazil, Capo Verde, Kroaci, Federazioni Serbi-Mali i Zi, Maqedoni, Principata e Monako, Republika San Marino, Tunizi e Svizer.*

Atyre ASL i kompetences territoriale ju leshon **"libretin e shendetit"** qe parashikon asistencen sanitare njelloj si qytetareve italiane (perjashtuar mjekun e familjes dhe pediatrin me zgjedhje te lire)

## 3) TE HUAJ QE NUK KANE PERMESSO DI SOGGIORNO DHE KERKUES ASILI TE MBAJTUR NE QENDRAT E QENDRIMIT TE PERKOHSEM OSE NE QENDRAT E IDENTIFIKIMIT – TESERA STP (STRANIERO TEMPORANEAMENTE PRESENTE – I HUAJ PERKOHESISHT PREZENT)

Te huajve qe nuk kane permesso di soggiorno dhe atyre qe kane keruar azil te mbajtur prane Qendrave te Qendrimit te Perkohsem ose prane Qendrave de Identifikimit u sigurohet njelloj:

- kurimet ambulatoriale e spitalore urgjente ose esenciale edhe kur ato jane te vazhdueshme, per semundje ose fatalitete. Pervec kurimeve urgjente qe nuk mund te jepen nese nuk ekziston venia ne rrezik e jetes ose e shendetit te personit, garantohen edhe kurimet esenciale per semundjet jo te rrezikshme por qe nese nuk kurohen mund te demtojne shendetin dhe te vene jeten ne rrezik (per shembull semundjet si diabeti, semundjet e zemres, te mushkerive, tensioni etj)
- programet e mjekimit paraprak. Ne menyre te vecante mbrohen:
  - shtatezania dhe materniteti
  - shendetit i te miutrive
  - vaksinimet
  - nderhyrjet e profilaksit nderkombetar

– parandalimi, diagnoza dhe kurimi i semundjeve infektive  
Keto shërbime behen pa pagese per pacientin kur ky deklarone qe nuk ka asnje lloj te ardhure.

**Ne baze te ligjit italian, hyrja ne strukturat sanitare nga ana e te huajt ne rregull me lejen e qendrimt (permesso di soggiorno) nuk sjell asnje lloj sinjalizimi autoriteteve te sigurise publike, pervec rasteve qe kane te bejne me fakte kriminale.**

#### **Vendi dhe kushtet per kerkesen e Teseres S.T.P**

Qytetari i huaj jo ne rregull me dokumentat, edhe se pa asnje dokument, duke shkuar ne strukturat kompetente te Ndermarrjes Sanitare<sup>7</sup>, mund te kerkoje dokumentin sanitar me nje kodice regionale me sigel STP, me vlerë gjashtemujore, e rinovueshme ne rast ndodhjeje akoma ne territorin nacional, qe mund te perdoret per asistencen sanitare ambulatoriale e spitalore.

#### **4) ASISTENCA PER TE BURGOSURIT<sup>8</sup>**

Te huajt e burgosur ose te internuarit ne institutet ndeshkimore, ne regjim lirie te kufizuar ose masa te tjera denimi, jane te regjistruar ne SSN pavaresisht nga te qenit ne rregull me permesso di soggiorno ne Itali. Te tille subjekte ne periudhen e denimit, kane te drejta te barabarta me qytetaret e lire dhe jane te perjashtuar nga sistemi i pageses se shpenzimeve per shërbimet e dhena nga SSN.

### **ASISTENCA SANITARE**

#### **Qytetare Komunitare**

##### **1) QYTETARE TE BASHKIMIT EUROPIAN REZIDENTE NE ITAL<sup>9</sup>**

Te huajt qe kane nenshtetesine e Shteteve qe bejne pjese ne Bashkimin Evropian<sup>10</sup>, rezidente te rregullt ne Itali, jane te regjistruar detyrimisht me te njejtat kushte me qytetaret italiane rezidente, ne Sherbimin Sanitar Nazional. Regjistrimi behet prane Ndermarrjes Sanitare Lokale te rezidences dhe mbulon gjithë kohen ne te cilen eshte e vlefshme permesso apo carta di soggiorno per titullarin dhe familjaret ne ngarkim

##### **2) QENDRIM I PERKOSHHEM NE ITALI PER ARSYE TE NDRYSHME NGA PUNA<sup>11</sup>**

Qytetari i nje Shteti te Komunitetit Evropian, te Hapesires Ekonomike Evropiane<sup>12</sup> ose te Zvicres qe, gjate nje qendrimi te perkohshem ne Itali, ka nevoje per kura shëndetësore urgjente (ose te papritura), mund ti marre ato falas (pervec rasteve te pageses se nje ticket ne ngarkim te te asistuarit) prane strukturave publike e private te konvencionuara me SSN.

Per kete qellim, Ministria e Shëndetësise ka krijuar nje libret special qe u leshohet nga ASL te gjithë atyre qe prezantojne "Tëseren Evropiane te Siguracimit Sanitar" (qe, duke filluar nga 1 qershori 2004, zevendeson formularin E 111 dhe te ngjashmit me te).

Ky libret i quajtur "libretto-modulario" eshte i vlefshem ne te gjithë territorin italian, permban udhezimet per te perfituar shërbimet shëndetësore ne ambulancat dhe ne spitalet e SSN italiane me administrim te drejtperdrejte ose ne ato private zyrtarisht te konvencionuar.

Nese per cfaredolloj arsyeje nuk eshte i mundur perdorimi i "Tessera Europea di Assicurazione Sanitaria", me kthimin ne atdhe mund t'i kerkohe Siguracimit kthimi i shpenzimeve sanitare te paguara nga xhepi. Kjo gje mundesohet nga nje norme speciale e komunitetit e cila parashikon, vetem per rastet urgjente, te drejten e kthimit te shpenzimeve ne baze te tarifave te Shtetit ku eshte qendruar perkohesisht. Eshte e nevojshme, persa i perket kthimit te shpenzimeve, qe te prezantohen mandatet e pageses dhe dokumentacioni sanitar.

#### **LIBREZA E AFTESISE SANITARE**

Nga 19 janari 2004 ne Toskana eshte bere e pavleshme librezja e aftesise sanitare (**libretto di idoneità**

**sanitaria** L.I.S.A.) **per personelin qe ka te beje me trajtimin e artikujve ushqimore** (punonjesit qe bejne pergatitjen, transformimin, fabrikimin, amabalazhimin, depozitimin, trasportin, shperndarjen, trajtimin, shitjen ose furnizimin, perfshire servirjen, e produkteve ushqimore). Ndersa, njihet roli paresor i formimit dhe azhormimit te punonjesve te sektorit ushqimor dhe behet keshtu i detyrueshem frekuentimi i kursit te formacionit<sup>13</sup>, fale te cilit ngrihet niveli i njohjes se normale higjienike e te qendrimeve, te domosdoshme keto per te garantuar pastertine dhe sigurine e ushqimeve.

**Mbetet detyrimi per ASL-in, te leshoje L.I.S.A.-en atyre subjekteve qe punojnene sektorin ushqimor ne rrethe te tjera, ne te cilat eshte ende ne fuqi detyrimi i mbajtjes se nje librezje te tille.**

**Komuna Firenze<sup>14</sup> ka bere te pavlefshme librezjen e aftesise sanitare edhe per berberet, parrukieret dhe estetistet.** Per punonjesit e ketij sektori parashikohet nje formacion i vazhdueshem nga ana e Ndermarrjes Sanitare, ne bashkepunim me shoqatat e ketyre kategorive.

#### **DEKLARIMI I LINDJES SE NJE FEMIJE NE ITALI**

Kur lind nje femije, eshte e detyrueshme deklararimi i lindjes per regjistrimin ne regjistrin komunal te Gjendjes Civile.

##### **Subjektet e interesuara**

Deklarimi i lindjes mund te behet nga:

- nje nga prinderit
- person me procure speciale te nje prej prinderve
- nje mjek, mamia ose çdo person qe ka qene prezent ne lindje.

*Kush ben deklarimin duhet gjithmone te respektojë vullnetin e nenes ne rast se nuk do qe t'i njihet emri.*

#### **VENDI DHE KUSHTET PER REGJISTRIMIN:**

Deklarimi i lindjes mund te behet:

- brenda tre diteve nga data e lindjes:
  - prane spitalit ose shtepise se kures<sup>15</sup> ku ka ndodhur lindja dhe eshte marre nga drejtori sanitar<sup>16</sup> o nje person nga ai deleguar ose:
- brenda dhjete diteve nga data e lindjes ne nje nga vendet si vijon:
  - prane Zyres se Gjendjes Civile<sup>17</sup> te Komunes ne territorin e se ciles eshte bere lindja
  - prane Zyres se Gjendjes Civile te Komunes se rezidences se prinderve, nese e ndryshme nga ajo e lindjes
  - prane Zyres se Gjendjes Civile te Komunes se rezidences se nenes, nese e ndryshme nga ajo e lindjes, kur prinderit kane rezidenca te ndryshme
  - prane Zyres se Gjendjes Civile te Komunes se rezidences se babait, nese e ndryshme nga ajo e lindjes, kur prinderit kane rezidenca te ndryshme dhe jane dakord

#### **Per te bere kerkesen e regjistrimit jane te nevojshme:**

- **per te gjithë:** pasaporta
- **ne rast njohjeje te femijes natyral<sup>18</sup>:** deklarate nga ambasada ose konsullata e tyre nga e cila rezulton qe, ne baze te aplikimit te se drejtes nderkombetare private, asgje nuk pengon njohjen sipas ligjit kombetar te atij vendi
- **prinder te huaj qe duan t'i japin te porsalindurit mbiemrin e parashikuar nga ligji i tyre kombetar:** deklarate nga konsullata ose ambasada nga e cila te merret sakte mbiembri i femijes sipas ligjeve te atij Shteti

<sup>1</sup> Perjashtohen nga kjo e drejte ata qe kane kerkuar azil te mbajtur prane Qendrave te Identifikimit.

<sup>2</sup> Ligji i 23 dhjetorit 1999, n. 488, neni 42 pika 6:

“Duke filluar nga 1 janar 2000 regjistrimi ne Fondin sipas pikes 1, shtrihet per priferinjet dhe ministrat e kultit qe nuk zoterojne nenshtetesine italiane dhe ndodhen ne Itali sepse ne sherbim te kishes italiane e te Kishave ose enteve katalike te njohura zyrtarisht (\*), si dhe priferinjeve dhe ministrave te kultit qe zoterojne nenshtetesine italiane, qe punojne jashte ne sherbim te kishes italiane e te Kishave ose enteve katalike zyrtarisht te njohura (\*) Konsiderohen te aprovuara me ligj sipas nenit 8 te Kushtetutes: Kisha e perfaqesuar nga Tavolina Valdesa, Bashkimi i Kishave Krishtere Aveniste del Settimo Giorno, Assemblee di Dio in Italia (ADI), Unione Comunità Ebraiche in Italia (UCEI), Unione Cristiana Evangelica Battista d'Italia (UCEBI), Chiesa Evangelica Luterana in Italia (CELL)

<sup>3</sup> Neni 27, pika 1, shkronja a), i) e q) te T.U.

<sup>4</sup> sipas asaj qe eshte stabilizuar nga neni 6, pikat 7 e 8, te Tekstit te Vetem: “7. . . Gjithsesi vendbanimi i te huajit konsiderohet i perditeshem edhe ne rastin kur eshte i konsideruar zyrtarisht mysafir nga me shume se tre muaj prane nje “centro di accoglienza”. Mbi kryerjen e regjistrimit ose ndryshimit zyra jep komunikim kuestures kompetente per territorin. 8. Jashte rasteve te pershkruara ne piken 7, te huajt qe qendrojne ne territorin e Shtetit duhet t'i komunikojne kuestorit kompetent te territorit, brenda pesembedjete diteve te ardheshme, ndryshimet e vendbanimit te perditeshem qe mund te jene bere.”

<sup>5</sup> Parashikohet mospagesa e ticket per kategorite si vijon:

#### 1) Mospagesa e ticket per moshe e per kufi te ardhurash

I asistuari mund te perfitoje perjashtimin nga ticket per sherbime specialiste, te diagnosi in strumentale e laboratorike dhe per sherbime fisio-terapike, nese i perket njerës nga kategorite e meposhtme:

- femije te moshes nen 6 vjeç, ose pensionista me moshe mbi 65 vjeç, qe bejne pjese ne nje berthame familiare te ardhurat e se ciles nuk i kalojne 36.152€ ne vit
- pensioniste me me shume se 60 vjeç me pension ne minimum te ardhurat e te cileve nuk i kalojne 8.263€ bruto, nese jane te vetem (j/e veje, j/e ndare, j/e pamartuar) dhe 11.362€, nese kane bashkeshortin ne ngarkim. Te ardhurat e pensionistev me me shume se 60 vjeç jane te miteshme me 516€ per çdo femije ne ngarkim
- te papune, te regjistruar ne listat e Zyres se punes (me perjashtim te atyre qe jane ne pritje te punes se pare), te ardhurat e te cilene nuk i kalojne: 8.263€, nese jane te vetem (j/e veje, j/e ndare, j/e pamartuar) dhe 11.362€, nese me nje bashkeshort ne ngarkim. Te tilla te ardhura jane te miteshme me 516€ per çdo femije ne ngarkim
- familjare ne ngarkim te te papuneve qe hyjne ne rastet e siper permendura
- pensioniste sociale apo familjare ne ngarkim te pensionistev sociale.

#### 2) Perjashtimi nga pagesa per mbi 65 vjeçare

Perjashtimi per ilacet i lejohet subjekteve qe kane mbushur 65 vjeç dhe i perkasin berthamave familjare te ardhurat bruto te te cileve nuk i kalojne: 8.263€, nese mbi 65 vjeçari eshte vetem (j/e veje, j/e ndare, j/e pamartuar) dhe 11.362€ nese ka bashkeshortin ne ngarkim.

#### 3) Perjashtimi nga pagesa per invaliditet

Te gjitha kategorite e invalideve ( civile, te luftes, te punes e te sherbimit) jane te perjashtuar nga pagesa e ticket per sherbime specialiste, te diagnozave instrumentale dhe laboratorike si dhe per sherbime fiziko-terapike e ilace.

#### 4) Perjashtimi nga pagesa per semundje patologjike

Kush eshte i semure nga patologji te veçanta, semundje tumorale ose ne pritje te trapianteve te organeve, eshte i perjashtuar nga pagesa e ticket per sherbimet tek specialisti, te diagnozave instrumentale dhe laboratorike si dhe per sherbime fiziko-terapike qe kane te bejne me semundjen patologjike. Ndersa duhet te paguhet kuota fikse per ilacet.

#### 5) Perjashtim nga pagesa me qellim perkujdesjeje per shtatezanine

Grave shtatezana ju njihet mospagesa per sherbimet e diagnozave instrumentale dhe laboratorike si dhe per sherbime tek specialisti sipas ligjit qe parashikon nje protokoll specifik persa i perket grave shtatezana dhe perkujdesjen mbi maternitetin (Decreto i 10.9.98 - G.U. n° 245 i 20.10.98) Per njohjen e te drejtes se mospageses per semundje patologjike, invaliditet ose trapiant organesh, duhet shkuar prane zyra administrative te Sherbimit Distretual kompetent dhe duhet kerkuar nje atestat i posaçem qe u demonstronhet Mjekut te familjes dhe ASL-it. Dokumentat qe duhen prezantuar jane:

- deklarata e mjekut specialist te nje strukture publike qe te certifikojte patologjiine; ose dokumentacioni qe te atestojte gjendjen e invaliditetit
- librezha shendetesore
- kodin fiscal

Per grate shtatezana duhet qe mjeku kurues te percaktojte te drejten e mospageses mbi impenjimin e tij.

<sup>6</sup> Shiko piken 4.

<sup>7</sup> Per adresat e Qendrave social-sanitare konsulto “Guida ai Servizi” te Sherbimit te Emigracionit te Komunesi Firenze – [www.comune.firenze.it](http://www.comune.firenze.it)

<sup>8</sup> D.Lgs. 22.06.1999, n. 230

<sup>9</sup> Ministeria e Shendetesise D.M. 18/03/1999

<sup>10</sup> Austri, Belgjike, Qipro, Danimarka, Estoni, Finlande, France, Gjermani, Greqi, Irlanda, Italia, Letoni, Lituani, Luksemburg, Malte, Vendet e Uleta, Poloni, Portugali, Britanni e Madhe, Republika Çeka, Slovaki, Slloveni, Spanje, Suedi, Hungari.

<sup>11</sup> Reg. (CEE) n. 631/2004

<sup>12</sup> Islande, Liechtenstein, Norvegji

<sup>13</sup> L.R. 12.05.2003, n. 24 – Norma mbi hijenen personale te punonjesve te industrise ushqimore

<sup>14</sup> Urtheresa C.C. 66/17 del 24.02.2003

<sup>15</sup> Ligji n. 127/1997, neni 2

<sup>16</sup> Drejtori sanitar ka detyrimin qe t'i tasmetoje deklarimin, brenda dhjete diteve nga marja e tij, zyrtarin te Gjendjes Civile te Komunes se rezidencas se prinderve te te porsalindurit ose, ne rastin kur keto kane residence te ndryshme, te Komunes se rezidencas se nenes

<sup>17</sup> Per Komunen Firenze: Palazzo Vecchio, Piazza della Signoria: “Zyra e lindjeve dhe nenshtetesive” – dhoma n.1. Hapur: e hene – e premte orae 8,30 - 13.00. Qytetaret e huaj qe nuk njohin gjuhën italiane, duhet te shoqerohen nga nje perkthyes. Sherbimi eshte falas.

<sup>18</sup> Prinder jo te martuar

## CARTA DI SOGGIORNO

Carta di soggiorno eshte nje dokument qe **autorizon te huajin te qendroje ne territorin italian per nje kohe te pacaktuar.**

### Kujt i takon?

Te huajit qe qendron rregullisht ne territorin e Shtetit prej te pakten 6 vjetesh, titullar i nje permesso di soggiorno per nje arsye qe lejon nje numer te pacaktuar rinovimesh.

### Ku dhe si kerkohet?

Kerkoht kuestures se vendit ne te cilin eshte marre rezidenca, duke plotesuar ne dy kopje nje modular, qe terhiqet prane kesaj kuesture, mbi te cilin duhen shenuar:

- gjeneralitetet komplet
- vendi/vendet ne te cilat i huaji ka qendruar ne Itali ne 6 vjetet paraardhes
- vendi i rezidencas
- burimet e te ardhurave<sup>1</sup>, qe vijne edhe nga njohja e pensionit per invaliditet, duke specifikuar shumën

### Kerkeses i bashkangjiten:

- kopja e permesso di soggiorno
- kopja e pasaportes ose dokument ekuivalent, o dokument identifikimi te leshuar nga autoritet kompetente italiane nga e cila te rezultojne kombesia, data (edhe vetem viti) dhe vendi i lindjes
- kopja e deklarimit te te ardhurave leshuar nga punedhensesi ose Mod. CUD. per vitin paraardhes nga ku rezulton nje e ardhur jo me e vogel se shifra vjetore e çekut social
- certifikate te pastertise juridike<sup>2</sup> te çeshtjeve penale mundeshme ne vazhdim<sup>3</sup> qe duhet te kerkoht prane Gjykates
- 4 fotografi per dokument<sup>4</sup>
- marca da bollo €14,62

## E PER FAMILJARET?

**Carta di soggiorno mund te kerkoht per bashkeshortin e per femijet e mitur nen 18 vjeç bashkejetues.**

Nderkohe qe kushtet per 6 vjetet e qendrimit aplikohen vetem per kerkuesin, te ashtuquajturin kryetar familjeje, dokumentet qe vijojne duhen prodhuar edhe per familjaret per te cilet kerkoht carta di soggiorno e/ose regjistrimi ne te veten carta di soggiorno:

- gjeneralitetet komplet
- kopja e permesso di soggiorno
- kopja e pasaportes ose dokument ekuivalent, o dokument identifikimi te leshuar nga autoritet kompetente italiane nga e cila te rezultojne kombesia, data, edhe vetem viti, e vendi i lindjes
- 4 fotografi per dokument<sup>5</sup> per secilin familjar

### Kerkeses i bashkangjiten:

- **Dokumenta qe demostrojne lidhjen familjare** (certifikate martese, te lindjes, etj.), leshuar nga autotitetet kompetente te Shtetit perkates, te perkthyer e te legalizuara ne autoritetet konsullare italiane, perjashtuar dokumentacionin e leshuar sipas Konvencionit te Aja te vitit 1961 (dokumentacioni nuk kerkoht ne rastin kur femija i mitur ka hyre ne territorin nacional me vize per bashkim familjar)

- **Dokumentacion qe demonstron disponibilitimin e nje banese** qe respekton parametrat minimale te parashikuara nga ligji regional per banesat publike<sup>6</sup>
  - kopja e kontrates se pronesis se ose te qerases, te regjistruara
  - kopja e kontrates "comodato gratuito"
  - atestim te pershtatshmerise se baneses:
    - ose atestim te pershtatshmerise leshuar nga zyra komunale (origjinale)
    - ose certifikate te pershtatshmerise igjenike-sanitare te leshuar nga Ndermarrja Sanitare Lokale kompetente per territorin (origjinale)

**Nese kryetari/ja i familjes eshte punetor shtepiak** qe ka ne perdorim fjetje e ngrenie, eshte e mjaftueshme, nje deklarate si mysafir leshuar nga punedhenesi qe perfshin edhe familjaret e interesuar si dhe certifikata e gjendjes se tij familjare.

Nese kerkesa eshte per djalin/vajzen **me moshe nen 14 vjec**, qe ka hyre me nje nga prinderit, eshte e mjaftueshme konsensi i titullarit te baneses ne te cilen i/e mituri/a banojne.

- **Dokumentacion qe demonstron te ardhura** (te vitit paraardhes), jo me te uleta se vlera vjetore e çekut social, nese kerkohet venia e nje familjari te vetem, dyfishin e vleres nese kerkohet venia e dy ose tre familjareve, trefishin nese jane kater ose me shume familjare. Te ardhurat te cilave u behet referim jane ato te prodhuara nga te gjitha familjaret bashkejetues jo ne ngarkim (te bashkangjiten kopjet e deklarimit te te ardhurave ose te modelleve CUD te familjareve)
- **certifikate juridike** te bashkeshortit<sup>7</sup> e/ose te femijeve mbi 14 vjec<sup>8</sup>
- **certifikate te regjistrimit ne proçeset penale te mundeshme ne vijim**, te bashkeshortit<sup>9</sup> e/ose te femijeve mbi 14 vjec<sup>10</sup>

**Nese carta di soggiorno kerkohet nga bashkeshort i huaj, ose prind i huaj bashkejetues me nje qytetar italian ose me nje qytetar te nje Shtetit pjeseberes ne Bashkesine Evropiane rezident ne Itali**, nuk nevojitet dokumentacion per banesen. Te ardhurat demonstrohen nga kopja CUD ose Modello Unico bashkangjitur (qe demonstron te ardhurat e marra ne vitin paraardhes) te bashkeshortit italian ose komunitari.

I huaji qe ben kerkesen duhet te shenoje ne modular, pervec gjeneraliteteve te veta, edhe ato te bashkeshortit ose te femijes me te cilin bashkejeton.

Ne rast martese me qytetar italian ose komunitar, nuk kerkohen 6 vjetet e qendrimit ne Itali dhe carta di soggiorno, pervec kohes burokratike te pritjes, mund te kerkohet dhe leshohet menjehere.

Per te huajin qe eshte i mitur bashkejetues me nje qytetar italian ose te nje Shteti te Bashkimit Evropian rezident ne Itali, carta di soggiorno kerkohet nga ai qe ushtron zotesine mbi te miturin.

### Leshimi i carta di soggiorno

Kuestura leshon nje flete, ku shenon ditën ne te cilen carta mund te terhiqet. Kjo flete nuk zevendeson ne asnje menyre carta di soggiorno, qe leshohet gjithsesi brenda 90 diteve nga data e prezantimit te kerkeses, duke bere paraprakisht verifikim te kushteve te kerkuara (midis te cilave: mungesa e çeshtjeve penale ne vijim dhe mungesa e denimeve).

### Nese refuzohet ose revokohet?

I huaji mund te prezantoje kontestim ne Tribunale Amministrativo Regionale (TAR) – Gjykata Administrative e Rrethit kompetent brenda 60 diteve. EkspulSIONI i te huajit qe zoteron nje carta di soggiorno mund te behet vetem per arsye te renda te rregullit publik.

### Vlefshmeria e nje carta di soggiorno

Carta di soggiorno perben nje dokument identifikimi personal per jo me shume se pese vjet nga data e leshimit ose e rinovimit. Rinovimi behet me kerkesen e te interesuarit, kompletuar me fotografi te reja.

### Avantazhet e carta di soggiorno:

I huaji mund

- te hyje ne Itali pa vize
- te zhvilloje aktivitet ligjor, pervec atyre ligjeve qe ia ndalon shprehimisht te huajit ose sidoqofte ia rezervon vetem qytetarit italian
- te perfitoje nga sherbimet e dhena nga administracioni publik
- te marre pjese ne jeten publike lokale, duke ushtruar edhe elektorat kur kjo parashikohet nga urdheresat e enteve lokale

<sup>1</sup> Pagat e priferinjeve te Kishes Katolike konsiderohen "te ardhura te krahasueshme me ato te punes si dependent" (Ministria e Brendeshme. Departamenti i Sigurise Publike – Drejtoria qendrore e emigracionit dhe e policise kufitare. Circolare, 24 maj 2005)

<sup>2</sup> Gjykata Firenze, Pzsa S. Firenze, 5

<sup>3</sup> Prokuroria e Republikës - Firenze: Viale Spartaco Lavagnini 31

<sup>4</sup> Ne vend te fotografive me shume poza, te huajit mund t'i kerkohet te fotografohet nga aparati i posaçem per trajtimin e automatizuar te imazhit, te zoteruar nga zyra

<sup>5</sup> Shiko piken 4

<sup>6</sup> Per parametrat, shiko skeden "ricongiungimento familiare".

<sup>7</sup> Shiko piken 2

<sup>8</sup> Gjykata per te Miturit - Firenze, Via della Scala 79, Firenze

<sup>9</sup> Shiko piken 3

<sup>10</sup> Shiko piken 8

## **DISKRIMINIM PER ARSYE RACIALE, ETNIKE, KOMBETARE E FETARE**

(DISCRIMINAZIONE PER MOTIVI RAZZIALI, ETNICI, NAZIONALI E RELIGIOSI)

### **Subjektet e interesuara**

- gjithkush, qytetar i huaj apo italian, mendon se eshte diskriminuar ne ushtrimin e nje te drejte, ne perdorimin e nje sherbimi ose marrjen ne pune ne baze te races, ngjyres, prejardhjes apo origjines kombetare ose etnike, nenshtetese, grupit gjuhesor, bindjeve e besimeve fetare
- shoqatat dhe entet qe zhvillojne aktivitet ne fushen e luftes kunder diskriminimit dhe levrimitin e barazise ne trajtimin e personave, te regjistruar ne nje regjister te posaçem<sup>1</sup> prane Presidences se Keshillit te Ministrave (Departamenti per te Drejtat e Barabarta)
- perfaqesuesit lokal te organizatave sindakaliste me te medha ne nivelin kombetar.

### **Diskriminimi**

Dekreti i *"Aktualizimit te direktivave 2000/43/CE* per trajtimin e barabarte te personave pavaresisht nga raca dhe origjina etnike"<sup>2</sup> permban dispozitat mbi aktualizimin e barazise midis personave pavaresisht nga raca apo origjina etnike, duke dhene masat e nevojshme me qellim qe diferencat e races dhe origjines etnie te mos behen shkak per diskriminim, edhe duke mbajtur parasysh efektin e ndryshem qe te njejtat forma diskriminimi mund te kene mbi grate e burrat, si edhe egzistencen e formave te racizmit me karakter kultural e fetar.

Parimisht, me barazi ne trajtim kuptohet mungesa e çdo lloj diskriminimi direkt ose indirekt per shkak te races ose te origjines etnike. Ky parim sjell mospraktikimin e asnjelloj diskriminimi direkt apo indirekt.

- diskriminimi direkt eshte kur, per shkak te races ose origjines etnike, nje person trajtohet ne menyre me pak te favorshme me te cilin eshte ose do ishte trajtuar nje tjetere person ne ne te njejtin situatë;
- diskriminimi indirekt eshte kur nje dispozite, nje kriter, nje procedure, nje akt ose nje pakt apo sjellje qe ne aparence duken neutrale, mund te vene personat e nje race apo te nje origjine etnike te caktuar, ne nje pozicion veçanerisht te pafavorshem kundrejt personave te tjere.

Konsiderohen diskriminime edhe besdisjet apo me mire ato lloj sjelljesh te padeshiruara, te bera per motive raciale ose te origjines etnike, me qellim qe te dhunojne dinjitetin e nje personi dhe te krijojne nje klime ndrojtese, agresive, degraduese, poshteruese e ofenduese.

### **Kryen nje diskriminim:**

- zyrtari publik ose personi i ngarkuar i sherbimit publik ose personi qe ushtron nje sherbim publik qe ne ushtrimin e detyrave te tij, kryen ose ben akte jo te parashikuara nga ligji kundrejt nje qytetari italian apo te huaj, vetem per shkak te kushteve te tij ose te berjes pjese ne nje race, etni ose kombesi te caktuar.
- gjithkush qe imponon kushte me te sfavorshme ose refuzon dhenien ose kryerjen e sherbimeve publike nje te huaji, vetem nga shkak i te qenit i huaj apo sepse i perket nje race apo nje etnie o kombesie te caktuar;
- gjithkush qe ne menyre te paligjshme imponon kushte me te sfavorshme ose refuzon kryerjen e sherbimeve te ndryshme si marrjen ne pune, dhenien e nje banese, nje shkollimi, apo te sherbimeve sociale e socio-asistenciale te huajit rregullisht ne Itali vetem per faktin se ai eshte i huaj ose pse i perket nje race apo nje etnie o kombesie te caktuar;
- gjithkush qe pengon nepermjet veprimeve ose mos lejimeve, ushtrimin e nje aktiviteti ekonomik ligjerisht te filluar nga nje i huaj banues i rregullt ne Itali, vetem per faktin se ai eshte i huaj ose pse i perket nje race te caktuar apo nje etnie o kombesie;

- punedhenesi ose te ngarkuarit e tij te cilet bejne nje akt ose sjellje qe direkt ose indirekt, kryen diskriminim ne dem te punetoreve, vetem pse ata i perkasin nje race apo nje grupi etnik ose gjuhesor, nje feje ose nje nenshtetese.

### **Organet e referimit**

- Gjykata e vendit ne te cilin eshte banues i interesuari, duke prezantuar nje padi qe ekzaminohet nga gjykatesi, i cili mund te urdheroje mbarimin e nje sjelljeje diskriminuese dhe te marrre çdo mase tjetere per te hequr pasojat e diskriminimit. Gjykatesi mund, nese e konsideron padine te vlefshme, te denoje
- pergjegjesit e aktit diskriminues qe te zhdemtojne edhe ne rast se nuk behet fjale per dem material, te ashtuquajturin dem moral.
- Qendra Regionale e vezhgimit, informacionit dhe asistences ligjore viktimave te diskriminimit per arsye raciale, etnike, kombetare ose fetare.

### **Kohet**

Ne raste urgjente gjykatesi merr masat nepermjet nje dekreti te motivuar, duke marre kur eshte nevoja informacione te pergjithshme. Ne kete rast fikson me te njejtin dekret, seancen e paraqites se paleve ne gjyq para tij brenda nje kohe prej 15 ditesh, duke vendosur menjehere nje skadence prej jo me shume se 8 ditesh per notifikimin e padise e te dekretit. Ne kete seance, gjykatesi me nje urdher, konfermon, modifikon ose anulon masat e marra ne dekret.

Prane Presidences se Keshillit te Ministrave – Departamenti per Te drejtat e Barabarta eshte krijuar **Zyra Kombetare Kunder Diskriminimeve Raciale<sup>3</sup> (Ufficio Nazionale Antidiscriminazioni Razziali - UNAR)**, i cili, jo vetem shkruan nje relacion vjetor per Parlamentin e per Presidentin e Keshillit te Ministrave mbi aktivitetin e zhvilluar per te mbeshetur studime, kerkime, kurse formacioni e shkembimi eksperience, ne bashkepunim me shoqatat dhe entet e shenuara ne regjister, me organizatat e tjera jo qeveritare qe punojne ne kete sektor, me institutet e specializuara ne te dhena statistike, edhe me qellim qe te perpunojne linja drejtuese ne fushen e luftes kunder diskriminimit, **ka per detyre qe te:**

- furnizoje asistencë, ne procedurat juridike apo administrative te ndermarra, personave qe konsiderohen te demtuar nga sjellje diskriminuese
- zhvilloje duke respektuar cilesite dhe funksionet e autoriteteve juridike, hetime me qellim qe te verifikojne egzistencen e fenomeneve diskriminuese
- mbeshtese marrjen nga ana e subjekteve publike e private, ne veçanti nga ana e shoqatave dhe e enteve te shenuara ne regjistrin e posaçem, masave specifike, perfshire ketu projekte aktesh positive me drejtim evitimi ose kompensimi te situatave te pafavorshme te lidhura me racen ose origjinen etnike
- shperndaje maksimumin e njohjes se instrumenteve te mbjrojtjes qe egzistojne edhe nepermjet akteve te sensibilizimit te opinionit publik mbi bazen e barazise dhe te realizimit te fushatave te informacionit e komunikacionit
- formuloje e te rekomandoje opinionet mbi çeshtjet e lidhura me diskriminimin per racen, origjinen etnike, si edhe propozime mbi modifikimin e ligjeve ne fuqi.

Denoncimet mund te prezantohen ne **UNAR** edhe nepermjet sherbimit telefonik ne **numrin jeshil 800 90 10 10<sup>4</sup> ne funksionim çdo dite nga ora 10.00 deri ne oren 20.00 i disponueshem ne italisht, anglisht, frengjisht, spanjisht, arabisht, rusisht, rumanisht, kineze mandarino** e nepermjet **web<sup>5</sup>.**

## REGJISTRIMI ANAGRAFIK<sup>1</sup> (GJENDJE CIVILE) DHE DETYRIMET E MIKPRITESIT

(ISCRIZIONE ANAGRAFICA<sup>1</sup> E OBBLIGHI DELL'OSPITANTE)

### Regjistrimi anagrafik<sup>2</sup> behet

- per lindje<sup>3</sup> ne zyren e komunes se residences se prinderve ose ne komunen ku eshte regjistruar nena ne rast se prinderit jane te regjistruar ne dy vende te ndryshme;
- kur prinderit nuk njihen, ne gjendjen civile ku eshte shkruar personi ose bashkejetuesit te cileve u eshte dhene ne kujdestari i mituri
- per egzistence juridikisht te deklaruar
- per transferim te residences nga nje komune tjeter ose nga jashte shtetit deklaruar nga i interesuari ose verifikuar nga zyrtari i gjendjes civile<sup>4</sup>, duke mbajtur parasysht dispozitat e vecanta te personave **pa banese te perhershme**<sup>5</sup> (qe konsiderohet rezident ne komunen ku ka adresen e ne mungese te saj, ne komunene e lindjes<sup>6</sup>) dhe per mungese regjistrimi ne gjendjen civile te asnje komune tjeter;

Te burgosurit e huaj regjistrohene ne gjendjen civile te komunes ku ndodhet instituti i ndeshkimit (burgu), pasi qendrimi i tyre ne Itali percaktohet nga egzistenca e nje denimi qe i detyron te qendrojne<sup>7</sup>. Nese nje regjistrim i tille nuk behet nga drejtori i institutit, zyrtari i gjendjes civile ben ekzekutimin e e kopetences (shiko piken 4). Spostimet qe lidhen me arsye gjyqesore nuk mund te influencojne mbi vendin e regjistrimit anagrafik te te burgosurit, dhe as mund t'a bejne te konsiderueshem si i pabanese.

Nuk duhet te behet as nga zyra dhe as nga i interesuari regjistrimi ne gjendjen civile te Komunes, per transferim residence, te te burgosurve ne pritje te gjykimit<sup>8</sup>.

Te huajt e regjistruar ne gjendje civile duhet te rinovojne deklaraten e vendbanimit te zakonshem ne komune, brenda 60 ditesh nga rinovimi i permesso di soggiorno (regjistrimi nuk behet i pavlefshem gjate rinovimit te permesso di soggiorno)

Per te huajt titullare te carta di soggiorno, rinovimi i deklarimit te vendbanimit te zakonshem duhet te behet brenda 60 diteve nga rinovimi i carta di soggiorno. Zyrtari i gjendjes civile azhornon skeden anagrafike te e huajit, duke dhene komunikim kuestorit.

Per personat e fshire nga regjistri per mosgetje e pastaj riperzantuar, duhet bere regjistrim i ri ne gjendjen civile. Vendbanimi i nje te huaji konsiderohet i perhershem edhe ne rast se dokumenton qe eshte mysafir prej me shume se tre muajsh prane nje qendre pritjeje. Nese zyrtari i gjendjes civile verifikon egzistencen e vendbanimit te perhershem, afati i permesso di soggiorno, duke patur parasysht qe ne momentin e vendosjes se regjistrimit duhet te jete e vlefshme, apo tipi ikesaj permesso nuk mund te krijojne pengesa per regjistrimin anagrafik<sup>9</sup>.

Regjistrimet, ndryshimet<sup>10</sup> ose fshirjet anagrafike i komunikohen nga zyra, kuestures kopetente per territorin. Ndryshimet e mundshme te vendbanimit, nese nuk ka patur regjistrim ne gjendjen civile<sup>11</sup> duhet t'i komunikohen nga i huaji kuestures kopetente per territorin brenda 15 diteve.

### Menyrat

Kerkesa duhet te prezantohet nga nje komponent i rritur i familjes.

### Per regjistrimin e pare ose per ndryshimin e residences<sup>12</sup> duhen:

- pasaporta e vlefshme (per qytetaret e Komunitetit Evropian eshte e mjaftueshem karta e identitetit te vendit te vet) ose karta e identitetit leshuar nga nje tjeter Komune italiane

<sup>1</sup> Shoqatat dhe entet e shkruajtura ne liste, jane edhe te autorizuar te reagojne ne raste diskriminimi kolektiv nese nuk individualizohen ne menyre direkte dhe te menjehereshme personat e demtuar nga diskriminimi.

<sup>2</sup> Dekreti Legjislativ 9.07.2003, n. 215 - G.U. n. 186 i dates 12.08.2003

<sup>3</sup> Departamenti per te Drejtat e Barabarta, via Barberini, 38 - 00187 Roma - Sekretaria 06 42153488 - 06 42153261, sito web [www.pariopportunita.gov.it](http://www.pariopportunita.gov.it) - e-mail [antidiscriminazioni@pariopportunita.gov.it](mailto:antidiscriminazioni@pariopportunita.gov.it)

<sup>4</sup> Qendra e kontaktit administruar nga UNAR e nga Shoqata ACLI, e cila disponon nje rrjet strukturash te shperndara ne te gjithë territorin nacional; kjo qender mund te shfrytetoje nje sherbim konsulence e asistence teknike te siguruar nga nje grup ekspertesh te pranishem ne qendren e 5 makrozoneve gjeografike, ne qendren e Padova, Milano, Roma, Napoli e Catania.

<sup>5</sup> shiko piken 3.

- permesso di soggiorno e vlefshme (nese eshte leshuar per te paren here duhet te kete vlefshmeri te pakten tre muaj)
- dokumenta origjinale mbi gjendjen civile te personit (martese, divorc, vejeshmeri etj.). Keto dokumenta mund te jene:
  - origjinale te leshuara nga autoritetet kopetente te Shtetit ne te cilin eshte verifikuar ndodhja, shoqeruar nga nje perkthim ne italisht konform tekstit te huaj
  - origjinale te legalizuara leshuar nga autoritetet kopetente te Shtetit ne te cilin eshte verifikuar ndodhja qe mund te jene te perkthyer prane Petures<sup>13</sup>
  - nje deklarate qe permban te gjitha te dhenat anagrafike, leshuar nga konsullata ose ambasada e vet, me firme te legalizuar prane Prefektures kopetente.
- titullaret e nje patente italiane e/ose karte qarkullimi te automjeteve, duhet te plotesojne nje modular qe u dorezohet ne momentin e prenotimit.

### KUIDES

**Eshte e domosdoshme perputhja e persosur e te dhenave te permbajtura ne dokumntin e identitetit dhe te dhenave mbi permesso di soggiorno.**

**Nuk do te jete e mundur te merret certifikata e te dhenave mbi gjendjen civile, pa prezantuar dokumentat origjinale.**

### Per ndryshim adrese<sup>14</sup> duhen:

- dokumenti i identitetit i vlefshem (pasaporte ose karte identiteti)
- permesso di soggiorno te vlefshme (te te gjitha personave qe nderrojne adresen)
- per titullaret e nje patente italiane e/ose karte qarkullimi te automjeteve, protesimi i nje modulari qe u dorezohet ne momentin e prenotimit.

Regjistrimi ne gjendjen civile i kerkesave per regjistrim, nderrim rezidence e nderrim adrese behet vetem mbase Policia Komunale ka verifikuar qe kerkuesit jetojne efektivisht ne banesen e deklaruar. Ne rast rezultati pozitiv te verifikimit, data e rezidences ose e nderrimit te saj do te konsiderohet ajo ne te cilin eshte ajo ne te cilin eshte prezantuar kerkesa ne sportelin e Zyres se Gjendjes Civile.

Te gjitha ata qe regjistrohen, nderrojne rezidence ose adrese duhet te prezantojne kallezimin ne Drejtorine e Taksave per taksen e plehrave urbane. Modulari qe duhet mbushur prezantohet ne sportelin prane Gjendjes Civile.

### Fshirja nga anagrafe ndodh

- per transferim te rezidences ne nje komune tjeter ose jashte shtetit, dhe per transferim te vendbanimit ne nje komune tjeter per personat pa vendbanim te perhershem;
- per mosgjetje ne rast operacioni per regjistrimin e pergjithshem te popullsisë ose kur mbase kontrollon vazhdueshme, personi rezulton i pagjetur dhe per shkak te mungeses se rinovimit te deklarates se vendbanimit te zakonshem, pasi ka kaluar nje vit nga data e skadimit te permesso di soggiorno ose te carta di soggiorno. I huaji lajmehet dhe ftohet qe t'a beje kete brenda 30 diteve te ardhshme.

**Karta e identitetit, pervec rasteve kur marreveshje ose akorde nderkombetare thone ndryshe<sup>15</sup>, nuk eshte e vlefshme per jashte shtetit, dhe as nuk lejon qe i huaji te rrije ne Itali ne mungese te permesso di soggiorno.**

### DETYRIME TE MIKPRITESIT E TE PUNEDHENESIT

Gjithkush, e me çdo titull, jep strehim ose mikpret nje te huaj ose te pa nenshtetesi edhe nese i aferim apo fis, dhe e merr ne pune per cfaredo lloj arsyeje ose jep atij pronesine ose perdorimin e nje prone te paluajshme, ne fshat o ne qytet, vendosur ne territorin e Shtetit, duhet te jape komunikacion te shkruar brenda 48 oreve, autoritetve te sigurimit publik.

Komunikacioni perfshin, pervec gjeneraliteteve te denoncuesit, edhe ato te te huajit apo apolidit, te dhenat e pasaportes ose te dokumentit te identifikimit qe i perkasin, vendodhjen e sakte te prones se paluajshme ne te cilin personi jeton, eshte mysafir ose kryen sherbim dhe titullin per te cilin behet ky komunikim dhe fotokopjen e permesso ose carta di soggiorno te te huajit mysafir.

Moszbatimi i ketyre dispozitave ligjore ndeshkohen me gjobe nga 160 deri ne 1100 euro.

<sup>1</sup>Komuna Firenze, Zyra Anagrafe – Via dei Leoni 5, e hene - e shtune ora 8.30-13.00; e enjte ora 8.30-18.30

<sup>2</sup>Kujdes: nese emigrimi, nderimi i rezidences ose i adreses ndodhin prane nje berthame familjare egzistuese (d.m.th e pranishme ne te njejtin apartament dhe e regjistruar ne gjendjen civile), deklarimi duhet te nenshkruhet, jo vetem prej atij qe kerkon regjistrimin ose nderimin e adreses, por edhe prej nje perberesi te ritur te berthames familjare egzistuese. Nese kerkohet prane nje dhome ose hoteli, eshte e nevojshme te prodhohet nje deklarate e titullarit qe te permbaje shprehimisht autorizimin qe te regjistrohet prane ketij hoteli.

<sup>3</sup>Nuk eshte e nevojshme te futet i mituri ne soggjionon e njerit prej prinderve ne rastin e regjistrimit anagrafik te te miturit pasi ajo behet direkt nga momenti i lindjes (Circolare e Ministrise se Brendeshme n. 32/2004 – Regjistrimi anagrafik i te miturve te lindur nga prinder te huaj irregullisht rezidente)

<sup>4</sup>Ne baze te D.P.R. 30 maj 1989, n. 223, dhe Ligjit te 24 dhjetorit 1954, n. 1228, kur zyrtari i gjendjes civile te verifikojte nje trasferim te rezidences nga nje komune tjeter ose nga jashte shtetit, pa u regjistruar ne gjendjen civile ose pa komunikuar levizjen e pozicionit te vet (krijim te nje familjeje te re, ndryshime ne perberjen e familjes apo te bashkejeteses, ndryshim te kryetarit te familjes ose te pergjegjesit te bashkejeteses, te kualifikimit profesional ose te titullit te studimit) ai e fton te rregulloje pozicionin e vet

<sup>5</sup>Ne baze te Urdherit te Kryetarit te Bashkise (Sindaco) Firenze n. 2005/00474 te 13.06.2005, te gjitha ata qe gjenden pa vendbanim te perhershem por zakonisht banojne ne territorin komunal, mund te marrin rezidence e vet anagrafike prane via L. Lastrucci (ish Shtepia Komunale) ose te marrin pjese ne proceduren "residenza si celes per hyrjen ne perkallimet sociale per personat pa banim te perhershem", parashikuar nga ky urdher.

<sup>6</sup>Ligji 24 dhjetor 1954, n. 1228, Neni 2

<sup>7</sup>Ministria e Brendeshme – Shenimi ne protokollin 200502093-15100/4208 te 19 prillit 2005 "Regjistrimi anagrafik i te burgosurve te huaji"

<sup>8</sup>D.P.R. 30 maj 1989, n. 223, Neni 8 pika 1 c

<sup>9</sup>Ministria e Brendeshme (circolare n. 28 e 23/12/2002) ka urdheruar qe me qellim regjistrimi anagrafik, ne prani te nje permesso di soggiorno te vlefshme, te mos mbahet parasysht afati dhe tipi i saj. Natyrisht zyrtari i gjendjes civile nuk mund te mos kryejte vleresimet qe mbulon kopetencia e tij, d.m.th verifikimi i egzistences se vendbanimit te perhershem, qe do te vleresohet ne menyre te pergjithshme edhe nepermjet nje vleresimi te permesso di soggiorno. Me fjale te tjera, nese zyrtari i gjendjes civile verifikon egzistencen e vendbanimit te perhershem, afati i permesso di soggiorno qe ne momentin e regjistrimit eshte e vlefshme, ose tipi i saj, nuk mund te krijohet pengese per regjistrimin anagrafik. Zyrtari i gjendjes civile nuk mund te refuzojte kerkesen per regjistrimin anagrafik nga ana e kujt demonstron nje (te vlefshme) permesso di soggiorno me kohe te kufizuar (p.sh. per turizem, studime ecc.) d.m.th. Te tille qe mund te lere dyshim per te supozuar qe mungon egzistenca e nje vendbanimi te perhershem; do te jene verifikimet e metejshme qe zyrtari i gjendjes civile ka kopetencen qe t'i kryejte, te cilat do te mund te formojne nje binde per te mbeshtetur ose refuzuar kerkesen per regjistrim ([www.piemmenews.it](http://www.piemmenews.it))

<sup>10</sup>Ndryshimi i adreses mund te behet vetem prane Zyrrave te Palazzo Vecchio, Via dei Leoni n. 5

<sup>11</sup>T.U. – Neni 6, pika 7: "Regjistrimet dhe ndryshimet anagrafike te te huajit rregullisht qendruen ne territor behen me te njejtat kushte me ato te qytetareve italiane me menyra te parashikuara nga rregullojta egzekutuese. Sidoqofte, vendbanimi i te huajit konsiderohet i perhershem edhe ne rast se eshte mysafir i dokumentuar qe prej tre muajsh ne nje qender pritjeje (accoglienza). Mbi ndodhjen e regjistrimit ose ndryshimit zyrra i jep komunikim Kuestures territoriale kopetente". e pika 8: "Jashte rasteve te pershkruara ne piken 7, te huajit qe qendrojnë ne territorin e Shtetit duhet t'i komunikojne kuestorit kopetent per territorin, brenda pesembedhjetete diteteve te ardhshme, ndryshimet e mundeshme te adreses se zakonshme".

<sup>12</sup>Regjistrimi kur vjen nga jashte shtetit ose nga nje Komune tjeter

<sup>13</sup>Pretura Firenze: Piazza San Martino n. 2 – tel. 055 264271

<sup>14</sup>Trasferimi nga nje apartament ne nje tjeter ne te njejtin qytet

<sup>15</sup>Austria, Belgjika, Qipro, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Lettonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Vendet e Uleta, Polonia, Portugalia, Britania e Madhe, Republika Çeke, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Hungaria

## PUNE AUTONOME (PER LLOGARI TE VET) (LAVORO AUTONOMO)

### 1) VIZE HYRJEJE PER PUNE AUTONOME

#### Subjektet e interesuara

Te huajt qe duan te ushtrojne ne Itali nje aktivitet industrial, profesional, artizanal ose tregtar, apo qe duan te ndertojne nje shoqeri kapitalesh ose personash ose te hyjne ne aksione shoqerore.

#### Menyrat

Kur i huaji kerkon te zhvilloje aktivitet pune te pavarur, ai duhet t'i kerkoje autoritetit administrativ kopetent, edhe nepermjet nje prokurori te autorizuar prej tij, deklaraten qe nuk egzistojne arsye penguese per leshimin e titullit te aftesise ose autorizimit, sido qe te quhet ai, pasi jane pare kriteret dhe procedurat e parashikuara per leshimin e tij.

Ne limitin e kuotave te hyrjes te vendosura keto nga dekrete vjetore te leshuara nga Presidenti i Keshillit te Ministrave, mund te marre vizen e hyrjes per pune te pavarur, i huaji qe prodhon ne ambasaden ose konsullaten italiane keto dokumenta:

- 1) deklarate qe nuk ekzistojne arsye per te cilat nuk duhet te leshohet titulli i aftesise ose autorizimit, i nevojshem per zhvillimin ne Itali te aktivitetit te pavarur te zgjedhur;
- 2) atestat mbi parametrat financiar te referimit qe kane te bejne me disponibilitetin e burimeve financiare te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te punes se pavarur te zjedhur, leshuar nga Dhoma e Tregtise<sup>1</sup> kopetente per vendin ne te cilin aktiviteti i punes se pavarur do te zhvillohet ose nga urdheri profesional kopetent. Keto parametra, bazohen mbi disponibilitetin qe zoteron ne Itali kerkuesi, te nje shume jo me te vogel se vlera mujore e çekut social (nje atestim i tille kerkohet edhe per aktivitetet qe nuk kerkojne leshimin e asnje titulli aftesimi apo autorizimi)

#### Kerkesa dhe leshimi i nullaosta

Deklarata e pershkruar ne piken 1, se bashku me kopjen e kerkeses dhe dokumentacionin e prodhuar per leshimin e saj si dhe atestati i Dhomes se Tregtise, pershkruar ne piken 2, duhen prezantuar ne Kuesturen kopetente per territorin, per leshimin e nullaosta te perkoheshme me qellim hyrjen ne Itali. Ky nullaosta i perkoheshem vihet ne fund te deklarates se mesiperme brenda 20 diteve nga data e marrjes se saj duke qene bere paraprakisht verifikimi qe nuk egzistojne kundrejt te huajit arsye penguese per hyrjen dhe qendrimin ne territorin e Shtetit, per arsye pune te pavarur. Deklarata se bashku me nulla osta i leshohet te interesuarit ose prokurorit te autorizuar prej tij.

#### Kerkesa e vizes se hyrjes

Deklarata, atestati dhe nullaosta, me date jo me te larget se 3 muaj me pare, i prezantohen perfaqesise diplomatike ose konsullare per leshimin e vizes se hyrjes se bashku me:

- dokumentacionin qe verteton sistemimin e pershtatshem per fjetje ne Itali
- documentacion qe verteton disponibilitetin e nje te ardhure vjetore, qe vjen nga burime te ligjshme, te nje shume mbi ate te parashikuar nga ligji per perballimin e shpenzimeve sanitare

Perfaqesia diplomatike ose konsullare pasi ka vertetuar egzistencen e kushteve te kerkuara, mbi bazen e normativave dhe dokumentacionit te prezantuar, leshon brenda 30 diteve, vizen ne te cilen shenon aktivitetin te cilit i referohet dhe nje certifikate qe ateston egzistencen e kushteve te nevojshem per leshimin e permesso di soggiorno per pune autonome dhe jep komunikim Ministrise se Brendeshme, INPS-it dhe INAIL-it. Kjo vize duhet te perdoret brenda 180 diteve nga data e leshimit.

#### Kerkesa e permesso di soggiorno

I huaji duhet te prezantohet brenda 8 diteve nga data e hyrjes ne Itali, ne kuesturen kopetente per leshimin e permesso di soggiorno per pune te pavarur.

#### Dokumentacioni i kerkuar:

- kopja e pasaportes qe permban vizen e hyrjes
- 4 fotografi
- 1 marca da bollo €14,62
- certifikaten qe ateston egzistencen e kushteve te nevojshme per dhenien e permesso di soggiorno per pune te pavarur, leshuar nga perfaqesia diplomatike ose konsullare italiane

#### Permesso di soggiorno per pune te pavarur zgjat 2 vjet dhe eshte e rinovueshme.

### 2) SHNDERRIMI I PERMESSO DI SOGGIORNO PER STUDIME OSE FORMACION PROFESIONAL NE PUNE TE PAVARUR<sup>2</sup>

I huaji, titullar i nje permesso di soggiorno per studime ose formacion profesional te vlefshem, mund te kerkoje shnderrimin e nje te tille ne permesso di soggiorno per pune te pavarur.

#### Kerkesa e nullaosta

Kerkesa, e bere ne modularin<sup>3</sup> e posaçem, duhet te prezantohet ne Sportelin Unik per Emigracionin – Prefektura U.T.G. e provinces se rezidences se kerkuesit.

#### Dokumentat qe duhen bashkangjitur

- kopja e permesso di soggiorno e vlefshme per studime
- kopja e nje dokumenti identiteti te vlefshme
- kopja e certifikates se parashikuar nga ligji per aktivitetin e punes se pavarur te kerkuar, sikurse pershkruar ne listen e meposthme:

#### Profesionist i lire

- deklarate e leshuar nga Administracioni nenshtuar dhenies se titullit te aftesimit, licenca, autorizimi ose kallezimi per fillimin e aktivitetit, ose nga entet nenshtuar vigjilimit nga ana e urdherave profesionale;
- demostrim i nje te ardhure jo me te vogel se shuma vjetore e çekut social.

#### Sipermarres, tregtar ose artizan

- regjistrimi ne Dhomen e eTregtise te provinces ku mendohet te zhvillohet aktiviteti;
- fotokopja e fletes se dhenies se partita I.V.A.;
- deklarate e leshuar nga Administracioni nenshtuar dhenies se titullit te aftesimit, licenca, autorizimi ose kallezimi per fillimin e aktivitetit;
- demostrim i nje te ardhure jo me te vogel se shuma vjetore e çekut social.

#### Titullare te nje kontrate per kryerje sherbimi, konsulte, etc.

- certifikate e regjistrimit te nderrmarkjes per te cilen kryhet aktiviteti pune, aktive prej te pakten 3 vjetesh, nel Regjistrin e Ndermarjeve (visura camerale);
- kopja e bilancit te fundit te ndermarjes (nese eshte shoqeri kapitalesh) te depozituar prane Regjistrin e Ndermarjeve, ose te deklarimit te fundit te te ardhurave (nese shoqeri personash ose ndermarje individuale), nga e cila te rezultojte qe shuma e te perfitimeve eshte e mjaftueshme per te garantuar rrogen;
- kontrate pune, me te cilen t'i sigurohet punetorit te pavarur nje rroge shuma e te ciles te jete jo me e vogel se vlera e çeku social;
- kopja e deklarates se pergjegjesise, derguar Drejtorise Provinciale te Punes kopetente, ne te cilen te shkruhet qe si rrjedhoje i kontrates se nenshkruar, nuk do te restaurohet asnje raport pune si dependent.

**Sportista e atlete**

- deklaratë nominative të leshuar nga C.O.N.I.;
- demonstrim të një të ardhurë jo me të vogël se vlera e çekut social

**Partnere (ortake), administrues shoqërisht**

- kopja e aktit themelues të shoqërisë;
- çertifikatë të regjistrimit në shoqëri, aktive prej të pakten tre vjetësh, në Regjistrin e Ndermarrjeve (visura camerale);
- deklaratë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë që siguron për ortakun/partnerin që kryen punën, ose për subjektin që kryen funksione sociale, një të ardhurë me shumë vjetore jo me të vogël se vlera e çekut social;
- kopja e bilancit të fundit të ndermarrjes (nese është shoqëri kapitalesh) të depozituar pranë Regjistrin të Ndermarrjeve, ose të deklaramit të fundit të të ardhurave (nese shoqëri personash ose ndermarrje individuale), nga e cila të rezultojë që shuma e të përfitimeve është e mjaftueshme për të garantuar rrogën;
- kopja e deklaramit se përfaqësuesi, derguar Drejtorisë Provinciale të Punes kompetente, në të cilën të shkruhet që si rrjedhojë i kontratës së nënshkruar, nuk do të restaurohet asnjë raport pune si dipendënt.

**Artiste, balerine, punonjës të spektakleve**

- kontratë pune me firmë të autentifikuar të administruesit (ose të titullarit të liçencës së aktivitetit ose të sipërmarresit ose të një përfaqësuesi ligjor), me të cilën t'i sigurohet punëtorit të pavarur një të ardhurë me shumë vjetore jo me të vogël se vlera e çekut social;
- dokumentacion profesional i përshtatshëm që të atësojë aktivitetin e zhvilluar;
- çertifikatë të regjistrimit të shoqërisë me të cilën nënshkruhet kontrata e punës, në Regjistrin e Ndermarrjeve;
- kopja e bilancit të fundit të ndermarrjes (nese është shoqëri kapitalesh) të depozituar pranë Regjistrin të Ndermarrjeve, ose të deklaramit të fundit të të ardhurave (nese shoqëri personash ose ndermarrje individuale), nga e cila të rezultojë që shuma e të përfitimeve është e mjaftueshme për të garantuar rrogën;
- kopja e deklaramit se përfaqësuesi, derguar Drejtorisë Provinciale të Punes kompetente, në të cilën të shkruhet që si rrjedhojë i kontratës së nënshkruar, nuk do të restaurohet asnjë raport pune si dipendënt.

**Lexues universitare shkëmbimi apo të gjuhës së nënës**

- deklaratë leshuar nga universiteti ose nga instituti i shkollimit superior e i kerkimit, publik ose privat, që të atësojë zotërimin e kushteve profesionale të nevojshme për përbushjen e aktivitetit;
- demonstrim i një të ardhurë vjetore jo me të vogël se vlera e çekut social
- çertifikatë e Drejtorisë Provinciale të Punes ku atësohet që sipas programit nuk do të figurojë asnjë raport pune si dipendënt.

**Perkthyes e interpretues të gjuhës**

- titulli i studimit ose atëstati profesional i perkthyesit ose interpretuesit, specifikë për gjuhët e kerkuara, leshuar respektivisht nga një shkolle shtetërore ose ent publik ose tjetër institut barazor, sipas legjislatcionit në fuqi të shtetit që e ka leshuar, të nënshkruara nga përfaqësuesi diplomatikë ose konsullarë kompetentë;
- demonstrim i një të ardhurë vjetore jo me të vogël se vlera e çekut social
- çertifikatë e Drejtorisë Provinciale të Punes ku atësohet që sipas programit nuk do të figurojë asnjë raport pune si dipendënt.

**Leshimi i nullaosta dhe i permesso di soggiorno**

Nese nuk ka disponibilitetë kuotash ose nuk egzistojnë kushtet e parashikuara nga ligji për aktivitet pune të pavarur, Sporteli i Vetem (Unik) i jep komunikim të huajit, përndryshe e thirr për leshimin e çertifikatës që atëstojnë egzistencën e kushteve të parashikuara e i jep për t'a nënshkruar të interesuarit kerkesën e permesso di soggiorno për pune të pavarur, duke i komunikuar datën në të cilën ai mund t'a tërheqë.

<sup>1</sup> Dhoma e tregtisë, industrisë, artizanatit e agrikultures Firenze, Piazza dei Giudici 3, tel. 055 27951

Camera di commercio, industria, artigianato e agricoltura di Firenze, Piazza dei Giudici 3, tel. 055 27951

<sup>2</sup> Kerkesat mund të prezantohen vetëm në kuadrin e kuotave të hyrjes të stabiluara nga dekretet vjetore të leshuara nga Presidenti i Keshillit të Ministrave.

<sup>3</sup> Modulari për kerkesën mund të terhiqet pranë Sportelit Unik për Emigracione ose të shkarkohet në internet nga <http://www.welfare.gov.it/Sociale/immigrazione+ed+integrazione/modulistica+assunzioni+e+ricongiungimenti.htm>

## PUNE STINORE (LAVORO STAGIONALE)

### 1) VIZA E HYRJES PER PUNE STINORE

#### Subjektet e interesuara

Punetori I huaj rezident jashte shtetit, me te cilin punedhenesi italian ose i huaj me dokumenta te rregullta, rezident ne Itali, mendon te stabiloje nje raport pune stinore. Kerkesa mund te prezantohet edhe nga shoqatat e kategorise per hesap te pjesberesve ne shoqate. Ne kete rast, kerkesa e nullaosta dhe propozimi per nje "contratto di soggiorno" duhet te firmosen nga çdo punedhenes. Kerkesat per marrjen ne pune duhen prezantuar ne kuadrin e kuotave te hyrjes stabiluar nga dekretet vjetore te leshuara nga Presidenti i Keshillit te Ministrave.

Punetori qe respekton kushtet e kerkuara nga contratto di soggiorno per pune stinore dhe hyn ne Shtetin nga i cili ka ardhur ne momentin qe skadon permesso di soggiorno, ka te drejte precedence per rihyrjen ne itali ne vitin e ardhshem, gjithmone per pune stinore, kundrejt qytetareve te vendit te vet qe nuk kane hyre asnjehere ne Itali per te njejtën arsye.

Te huajit qe demonstroi qe ka ardhur ne itali per te pakten 2 vjet radhazi per pune stinore, mund t'i leshohet kur behet fjale per detyre te perseritshme, nje permesso shumevjeçare, me kete titull, deri ne vitin e trete, per kohezgjatjen vjetore ne te cilen ka perfituar ne vitin e fundit me nje urdher te vetem. Kjo vize hyrjeje i leshohet çdo vit.

Mbi bazen e nullaosta shumevjeçare per pune stinore, vizat per hyrje ne vitet e ardhshme mbas vitit te pare, leshohen nga konsullata, pas demonstrimit te kontrates per pune stinore, trasmetuar punetorit nga punedhenesi, qe merr masat gjithashtu per t'i trasmetuar nje kopje edhe Sportelit Unik kopetent.

#### Organet e referimit

Kerkesa per nullaosta per marrjen ne pune duhet te prezantohet ne Sportelin Unik per Emigracionin (S.U.) prane Prefektures – Zyra Territoriale e Shtetit e provinces ne te cilen eshte rezident, ose ne ate ku ka qendren zyrtare ndermarja, ose ne ate ku do te kete qendren aktiviteti i punes, edhe me referim trupi te grupeve te punes me periudhe me te shkurter qe do te zhvillohet prane disa punedhenesve<sup>1</sup>. Nese punonjesi do te jete nepunes prane disa qendrave pune, te shenohet qendra ne te cilen do te zhvilloje aktivitetin me konsistent.

#### Menyrat e prezantimit te kerkeses

- Kerkesa e nullaosta te punes, qe mund te jete
  - **nominative (me emer)**
